



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

RELACION

**ARSYETIMI I VENDIMIT NR. 2 _DATË 21.08.2025,
“MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE MASËS SË TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT
TË VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT NË SISTEMIN E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV”**

AKRONIME:

AAK	Agjenci e Administrimit Kolektiv
ALBAUTOR	Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e të drejtave të autorit për veprat letrare, artistike dhe shkencore, përveç administrimit kolektiv së të drejtave të autorit në fushën e veprave audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe veprat kinematografike
A.K.D.I.E.	Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues
FABER COLLECTIVE PHONOGRAM	Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit
F.A.A.D	Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale
BE	Bashkimi Evropian
DDA	Drejtoria për të Drejtën e Autorit
KKDA	Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit
LDA	Ligj Nr. 35/20216 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
OSHMA	Ofrues Shërbimi Mediatik Audioviziv
SUADA	Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit

I. BAZA LIGJORE

1.1. Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, janë mbajtur në konsideratë aktet e mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 350, datë 26.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)” (ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 27.11.2024);
- Vendim i KKDA-së Nr. 2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”
- Vendim i KKDA-së Nr. 3, datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”;
- Vendim i KKDA-së Nr. 2, datë 22.06.2018 “Për disa ndryshime të Vendimit Nr. 3, datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”
- Vendimi i KKDA-së Nr. 7, datë 11.10.2018 “Për disa ndryshime të Vendimit Nr. 3, datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, i ndryshuar”

1.2. Krahas bazës ligjore të identifikuar më sipër, KKDA-ja ka shqyrtuar dhe ka vlerësuar dokumentacionin, mendimet, propozimet dhe shpjegimet e palëve të përfshira në këtë proces, si dhe çdo rrethanë dhe të dhënë tjetër të nevojshme për marrjen e vendimit, duke përfshirë:

- Relacionin për draftin e metodologjisë së masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, për gatitur nga ekspertja ndërkombëtare Znj. Romana Matanovac Vučković dhe eksperti kombëtar Z. Eduart Gjokutaj, të caktuar me kërkesë të DDA-së për hartimin e një raporti që mund të shërbente si bazë për hartimin e metodologjisë së tarifave të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to;
- Qëndrimet, mendimet, propozimet dhe parashtrimet me shkrim dhe me gojë të AAK-ve dhe

përdoruesve kryesorë mbi metodologjinë dhe tarifat e shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv;

- Informacionin dhe të dhënat mbi të ardhurat e arkëtuara nga SUADA për periudhën kohore 2019-2024 dhe subjektet pagues të tarifave për vitin 2024;
- Metodologjinë dhe tarifat e zbatuara në vendet e rajonit, duke përfshirë vendet që kanë standarte të përafërta zhvillimi ekonomiko-social me Republikën e Shqipërisë.

II. OBJEKTIVI I KKDA-së NË ROLIN E RREGULLATORIT, MIRATIMIT DHE ZBATIMIT TË METODOLOGJISË, SI DHE FUSHA E ZBATIMIT:

2.1. Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (“**KKDA**”) është organi i specializuar i ngarkuar nga LDA-ja për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit, kur këto tarifa nuk janë të mundura të vendosen me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet AAK-ve dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve.

Në procedurën e miratimit të tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet vlera/tarifa dhe metodologjia për përcaktimin e tyre, për t’u paguar nga çdo përdorues për përdorimin e veprës/veprave të autorit që ato administrojnë.

2.2. KKDA-ja funksionin si organ kolegjal vendimarrës dhe këshillimor pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, dhe përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë, të cilët emërohen nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit për një periudhë katërvjeçare.

KKDA-ja ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e saj bazuar në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në zbatim të neneve 142, dhe 149 e vijues të LDA-së, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”, i ndryshuar, KKDA-ja vendos për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv.

Në ushtrimin e funksionit të tij rregullator, KKDA-ja vepron brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, duke ushtruar diskrecionin administrativ për të zgjedhur mjetet më të përshtatshme për realizimin e objektivit të ligjshëm. Në këtë kontekst, çdo vendimmarrje e KKDA-së në lidhje me metodologjinë për llogaritjen e tarifave është rezultat i një analize të balancuar ndërmjet interesit publik për të mbrojtur të drejtat e autorit e subjekteve të të drejtave të lidhura dhe të drejtave të përdoruesve për një trajtim të drejtë dhe të

arsyeshëm ekonomikisht. Gjithashtu, vendimmarrja e KKDA-së është e bazuar në kritere objektive, e argumentuar dhe e zhvilluar në përputhje me praktikat administrative të konsoliduara.¹

2.3. Vendimi i KKDA-së është i zbatueshëm për AAK-të e licensuara me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit dhe çdo përdorues së të drejtave të autorit në Shqipëri. Më konkretisht, vendimi i KKDA-së është i zbatueshëm për vlerën/tarifat dhe metodologjinë për përcaktimin e tyre në lidhje me pagesën që çdo përdorues duhet të paguajë kundrejt AAK-ve për përdorimin e veprave të autorit që ato administrojnë.

III. RRETHANAT E VENDIMMARRJES

3.1. Në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, KKDA-ja, me qëllim garantimin e një shpërblimi të drejtë për përdorimin e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, ka nxjerrë Vendimin Nr. 3, datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”, në zbatim të pikës 4(a) të nenit 156 të LDA-së.

Ky vendim ka pësuar ndryshime me Vendimin Nr. 2, datë 22.06.2018 “Për disa ndryshime të Vendimit Nr. 3 datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”, dhe më pas me Vendimin Nr. 7, datë 11. 10. 2018 “Për disa ndryshime të vendimit Nr. 3, datë 04.08.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv (i ndryshuar)”.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, tarifat e miratuara mbeten në fuqi për 2 vjet, por deri në hyrjen në fuqi të tarifave të reja, gjejnë zbatim tarifat e miratuara më parë.

3.2. Në vitin 2022, Agjencitë e Administrimit Kolektiv kërkuan fillimin e procedurës së miratimit të tarifave të reja të shpërblimit përmes kërkesës për lidhjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e shoqatave të përdoruesve të veprave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to. Kjo procedurë e filluar nga AAK-të përfundoi pa marrëveshje ndërmjet palëve. Si rrjedhojë, në përputhje me nenin 142(2) të LDA-së, kur marrëveshja gjithëpërfshirëse ndërmjet AAK-ve dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve nuk është e mundur, tarifat vendosen me vendim të KKDA-së.

Në këto rrethana, Drejtoria e të Drejtës së Autorit u angazhua së bashku me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (“**WIPO**”) dhe Projektin e Pronësisë Intelektuale Shqiptaro-Zvicerian (“**ALSIP**”) për të përfunduar këtë proces përmes ndihmës së ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë të specializuar. Ekspertët u ngarkuan me detyrën për hartimin e një raporti që mund të shërbente si bazë për hartimin e

¹ Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Nr.145 (86-2019-2047), datë 11.06.2019

metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

3.3. Më datë 08 dhe 09 Prill 2024, në ambientet e ish-Kinostudios, ekspertët kanë zhvilluar takime me Agjensitë e Administrimit Kolektiv dhe përfaqësuesit e shoqatave të përdoruesve, respektivisht. Këto takime janë zhvilluar në praninë e përfaqësuesve të Drejtorisë së të Drejtës së Autorit dhe i kanë mundësuar ekspertëve të njihen konkretisht me propozimet dhe mendimet e palëve.

Në vijim për sa më sipër, më datë 04.07.2024, ekspertët kanë hartuar dhe përcjellë draftin për metodologjinë e tarifave tek DDA-ja.

3.4. Këshilli i ri Kombëtar për të Drejtën e Autorit është konstituuar më datë 20.03.2025 përmes emërimit të kryetarit dhe katër anëtarëve përbërës të tij me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (“MEKI”).

3.5. Në vijim të konstituimit të Këshillit të ri Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), Agjencia e Administrimit Kolektiv “Albautor”, më datë 26.05.2025, ka paraqitur në KKDA dhe DDA shkresën me lëndë “Kërkesë për fillimin e procedurës për vendosjen e tarifave të përshtatshme në lidhje me përdoruesit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”.

Për sa më sipër, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, KKDA-ja, pasi ka administruar kërkesën e përcjellë nga AAK-ja “Albautor”, ka vendosur të zhvillojë një seri mbledhjesh me qëllim fillimin dhe zhvillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

- Më datë 11.06.2025, KKDA-ja ka zhvilluar mbledhjen e parë në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (“MEKI”), ku është njohur zyrtarisht me shkresën nr. 7027 prot., datë 26.05.2025 të Agjencisë së Administrimit Kolektiv “Albautor” me lëndë “Kërkesë për fillimin e procedurës për vendosjen e tarifave të përshtatshme në lidhje me përdoruesit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to”.

Në ushtrim të kompetencave ligjore për zhvillimin e kësaj procedure dhe marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e “Albautor”, KKDA-ja vendosi të fillojë procedurën administrative për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtave të lidhura me to, sipas parashikimeve të nenit 156(4) të LDA-së, dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

- Më datë 20.06.2025, KKDA-ja është mbledhur sërish në ambientet e MEKI-t, ku ka ftuar agjensitë e administrimit kolektiv dhe përfaqësuesit e subjekteve përdorues që të marrin pjesë dhe të japin propozimet e tyre në dy seancat e veçanta të caktuara për secilën palë lidhur me metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit.

Në këtë seancë kanë marrë pjesë dhe kanë shprehur propozimet e tyre: Sporteli unik i administrimit të të ardhurave ("SUADA"), dhe Agjensitë e Administrimit Kolektiv "Albautor", "AKDIE", "F.A.A.D", "Faber Collective Phonogram".

Gjithashtu, nga shoqatat e subjekteve përdorues, morën pjesë dhe paraqitën propozimet e tyre subjektet në vijim: Shoqata "RTL", "Tv Klan", "Tring tv", "Maxcom", "Top-Channel", "Digitalb", "Smart Solutions", "Vodafone" dhe "shoqata ATA".

Në këto seanca u administruan dokumente, opinione, shpjegime dhe propozime të ndryshme nga të gjithë palët pjesëmarrëse.

- Më datë 02.07.2025, KKDA-ja është mbledhur në ambientet e MEKI-t për shqyrtimin dhe diskutimin e projekt-metodologjisë së përgatitur nga ekspertët ndërkombëtarë dhe kombëtarë të caktuar nga DDA-ja, dhe për të analizuar të gjithë dokumentacionin dhe propozimet e administruara në procedurën e zhvilluar nga KKDA-ja.
- Më datë 07.07.2025, KKDA-ja është mbledhur në ambientet e MEKI-t, dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe informacionin e paraqitur në kuadër të procedurës për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, vlerësoi se çështja paraqet një shkallë të lartë kompleksiteti që kërkon një analizë më të thelluar dhe konsultime të mëtejshme. Në këtë kuadër, për të garantuar një vendimarrje të drejtë, të paanshme dhe transparente në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit të palëve pjesëmarrëse, u çmua e nevojshme zgjatja e afatit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes për një periudhë shtesë prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, në përputhje me nenin 92 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative".
- Më datë 09.07.2025, KKDA-ja është mbledhur në ambientet e MEKI-t për diskutime të mëtejshme lidhur me përcaktimin e strukturës së projekt-metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.
- Më datë 22.07.2025, KKDA-ja ka zhvilluar një tjetër mbledhje në lidhje me punën e nevojshme për seksionet përbërëse të strukturës së miratuar në mbledhjen paraprake, duke analizuar përmbajtjen dhe përputhshmërinë me komentet e paraqitura.
- Më datë 23.07.2025, KKDA-ja ka zhvilluar një tjetër mbledhje për të diskutuar më në detaje për projekt-metodologjinë dhe konsolidimin e përmbajtjes së saj.

3.6. DDA-ja, në cilësinë e sekretariatit teknik të KKDA-së, ka asistuar dhe ka vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e nevojshme për veprimtarinë e KKDA-së, ka mbajtur në mënyrë të rregullt procesverbalet e mbledhjeve, si dhe ka përmbushur rregullisht detyrën e saj për publikimin e vendimeve të KKDA-së. Po ashtu, në këtë proces, DDA-ja ka realizuar edhe komunikimet elektronike për njoftimin e palëve të interesuara: AAK-të, SUADA dhe subjektet përdoruese.

Në lidhje me dokumentacionin e depozituar nga palët pjesëmarrëse në procedurën e miratimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtës së autorit, KKDA-ja administroi çdo material, shkresë, dokument apo e-mail të paraqitur në lidhje me objektin e këtyre procedurave:

1. Shkresë e përbashkët nga Digitalb Sh.a., Top Channel Sh.a., Tring TV Sh.a., Media Vizion Sh.a. dhe TV Klan Sh.a. – Shkresë nr. 1043 prot., datë 17.08.2022 (Digitalb), shkresë nr. 484 prot., datë 17.08.2022 (Top Channel), shkresë nr. 640 prot., datë 17.08.2022 (Tring TV), shkresë nr. 30 prot., datë 17.08.2022 (Media Vizion), shkresë nr. 884 prot., datë 17.08.2022 (TV Klan), me lëndë “Propozime mbi metodologjinë për masën e tarifimit për subjektet përdoruese Televizione Kombëtare/Lokale”

2. Albautor - Shkresë nr. 85 prot., datë 31.10.2023 “Kërkesë për vendosjen e tarifave dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave të përdorimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me të, në lidhje me (i) komunikimin në publik në televizion të veprave të mbrojtura, (ii) përdorimin e veprave në mjediset kulturore, artistike, sportive (iii) komunikimin/përcjelljen/përdorimin e veprave në shfaqje/evente/koncerte, dhe (iv) parashikimin e mekanizmave nxitës për përdoruesit që të paguajnë përdorimin e veprave”;

3. Albautor - Shkresë nr. 982 prot., datë 24.01.2025 me lëndë: “Komente të agjencisë Albautor për draftin e metodologjisë së masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”;

4. Smart Solutions - E-mail datë 24.01.2025 me lëndë “Lidhur me draftin e metodologjisë së re të tarifave”;

5. Top-Channel - E-mail datë 24.01.2025 me lëndë “Propozimet e Top Channel mbi draftin e metodologjisë”;

6. Digitalb - E-mail datë 24.01.2025 me lëndë “Drafti i metodologjisë së re të tarifave dhe procedura për miratimin e tij”;

7. One.al – E-mail datë 24.01.2025 “Drafti i metodologjisë së re të tarifave dhe procedura për miratimin e tij”;

8. Vodafone Albania - E-mail datë 27.01.2025 “Drafti i metodologjisë së re të tarifave dhe procedura për miratimin e tij”;

9. Tv Klan- Shkresë nr. 1190 prot., datë 28.01.2025 me lëndë “Komente mbi draftin e metodologjisë së re të tarifave dhe procedura për miratimin e tij”;

- 10. Albautor-** Shkresë nr. 1224 prot., datë 29.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje Tv Klan sh.a për komentet mbi “Draftin e metodologjisë së re të tarifave”;
- 12. Tring Tv-** Shkresë nr. 1322 prot., datë 30.01.2025 me lëndë “Komente dhe propozime mbi “Draftin e metodologjisë së re të tarifave dhe procedura për miratimin e tij”;
- 13. Albautor-** Shkresë nr. 7027 prot., datë 26.05.2025 me lëndë “Kërkesë për fillimin e procedurës për vendosjen e tarifave të përshtatshme në lidhje me përdoruesit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to”;
- 14. Albautor** -Shkresë nr. 113 Prot., datë 26.05.2025 me lëndë “Komente të agjencisë Albautor për draftin e metodologjisë së masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”
- 15. Albautor** - Shkresë nr.7773 prot., datë 11.06.2025 me lëndë “Ndryshimin e përkufizimit të të ardhurave bruto të metodologjisë dhe masë tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv (draft metodologjia), duke hequr prej këtij përkufizimi dhe mos miratuar fjalinë “Shumat e arkëtuara për prodhimin e një programi radioteleviziv të porositur nga një person fizik apo juridik dhe që në fund bëhet pronë e tij”;
- 16. Tv Klan** - Shkresë nr. 8441 prot., datë 25.06.2025 me lëndë “Në vijim të takimit pranë KKDA”;
- 17. F.A.A.D** - Shkresë nr. 8080 prot., datë 18.06.2025 me lëndë “Parashtrime mbi përcaktimin e tarifave për përdoruesit”;
- 18. Albautor** - Shkresë nr. 8518 prot., datë 26.06.2025 me lëndë “Disa komente (vërejtje) përfundimtare në lidhje me tarifat e reja të propozuara”;
- 19. Vodafone Albania** – Email datë 25.06.2024 “Komente të Vodafone Albania mbi “Draftin e Metodologjisë së masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”
- 20. Albautor-** Shkresë nr. 8710/2 prot., datë 07.07.2025 “Shpjegime përfundimtare në lidhje me tarifat e reja”
- 21. AMA** - Shkresë nr. 1881 prot, datë 12.07.2025 “Kthim përgjigje në lidhje me aktivitetet specifike që një ofrues i shërbimeve audio dhe/ose audiovizive kryen në përputhje me licensën e dhënë nga AMA”.
- 22. ATA HORECA** - Shkresë datë 01.08.2025 “Propozime të shoqatës ATA HORECA në lidhje me Draftimin e Metodologjisë së masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e

autorit në sistemin e administrimit kolektiv për sa i përket tarifave të përdorimit të muzikës në subjektet akomoduese".

IV. RREGULLA TË PËRGJITHSHME DHE PROCEDURA PËR PERCAKTIMIN E TARIFAVE

4.1. Parime të përgjithshme

Në funksion të ushtrimit të kompetencës së saj rregullatore dhe në përmbushje të misionit për të garantuar një sistem të drejtë, transparent dhe të qendrueshëm të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit ("KKDA") mbështetet në parimet e mëposhtme:

- **Barazia e të drejtave të pjesëmarrësve** - Të gjithë palët trajtohen në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe me të njëjtat mundësi për t'u përfaqësuar.
- **Drejtësia dhe paanësia** - Garantimi i trajtimit të paanshëm dhe të drejtë për të gjitha palët e përfshira në proces.
- **Ligjshmëria** - Çdo vendim dhe veprim ndërmerret në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.
- **Papranueshmëria e konfliktit të interesit** - Shmangia e çdo situatë ku interesat personale të anëtarëve mund të ndikojnë në vendimmarrjen institucionale.
- **Pavarësia** - Vendimmarrja zhvillohet pa ndikime të jashtme, duke u bazuar vetëm në ligj, fakte dhe prova.
- **Përgjegjshmëria në marrjen e vendimeve** - Çdo vendim mbështetet në analiza të argumentuara dhe merret me përgjegjshmëri.
- **Profesionalizmi, cilësia, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit** - Ofrimi i një shërbimi me standarde të larta, të orientuar drejt rezultateve dhe përdorimit optimal të burimeve.
- **Ruajtja e konfidencialitetit** - Mbrotjtja e të dhënave dhe informacionit të ndjeshëm të palëve, në përputhje me detyrimet ligjore.

4.2. Ligji i zbatueshëm

Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to" i ndryshuar ("LDA"), rregullon në mënyrë të posaçme administrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në pjesën V të tij. Në përputhje me nenin 128 të LDA-së, administrimi i të drejtave të autorit dhe i të drejtave të lidhura përfshin detyrat e mëposhtme:

- a) dhënien e autorizimit për përdorim të objektit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura, objekt i mbrotjtjes, kur ky autorizim është i parashikuar me ligj;
- b) mbledhjen e shpërblimeve për përdorim të objektit të mbrotjtjes;
- c) shpërndarjen e shpërblimeve të mbledhura të mbajtësit të së drejtës;

- d) kontrollin e përdorimit të objektit të mbrojtjes;
- e) nisjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të mbrojtjes në rastet e shkeljes së të drejtave të administruara.

Administrimi i të drejtave mund të përfshijë të gjitha ose disa nga veprimtaritë e mësipërme. Në vijim, neni 130 i LDA-së përcakton kategoritë e të drejtave që mund të jenë objekt i administrimit kolektiv në mënyrë fakultative, ndërkohë që neni 131 parashikon kategoritë e të drejtave që i nënshtrohen administrimit kolektiv të detyrueshëm. Në rastet e administrimit kolektiv të detyrueshëm, zbatohet prezumimi ligjor i përfaqësimit, sipas të cilit agjencia përkatëse e administrimit kolektiv konsiderohet, *ipso jure*, si përfaqësuese e të gjithë mbajtësve së të drejtave për kategorinë përkatëse së të drejtave dhe për repertorin përkatës, pavarësisht nga fakti nëse këta mbajtës së drejtash janë ose jo anëtarë të agjencisë. Kjo dispozitë, e parashikuar në paragrafin 3 të nenit 131 të LDA-së, është thelbësore për garantimin e funksionalitetit dhe përfaqësueshmërisë universale të repertorit të administruar.

Tarifat që përfshihen në këtë metodologji i referohen shpërblimit të mbajtësve së të drejtave për përdorimin e të drejtave mbi veprat dhe objektet e tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv. Në procedurën e miratimit të tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet vlera/tarifa dhe metodologjia për përcaktimin e tyre, për t'u paguar nga çdo përdorues për përdorimin e veprës/veprave të autorit që ato administrojnë.

Procedura për caktimin e tarifave rregullohet nga Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar posaçërisht nenet 142 deri në 147, parimet për caktimin e masës së shpërblimit e parashikuara në nenin 149 të LDA-së, si dhe rregullat e përgjithshme që synojnë të garantojnë një proces të drejtë, transparent dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë.

V. TË DHËNA MAKROEKONOMIKE DHE TREGUESË ANALITIKË

5.1. Për hartimin e një metodologjie të bazuar në informacion të plotë në nivel kombëtar, është e domosdoshme që analiza të nisë nga treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët reflektojnë tendencat historike dhe ofrojnë një bazë të qëndrueshme për parashikimet e zhvillimeve të ardhshme. Një vlerësim i tillë është thelbësor për të kuptuar dinamikën e përgjithshme të ekonomisë, në të cilën operojnë dhe kontribuojnë edhe përdoruesit e të drejtave të autorit.

5.2. Në këtë kuadër, rritja ekonomike e shprehur në termat e ecures vjetore të Prodhimit të Brendshëm Bruto ("**PBB**") (vit/vit) për periudhën 2009–2024 paraqet luhatje të ndjeshme, të ndikuara nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Nga një rritje mesatare e qëndrueshme, ekonomia pësoi tkurrje të ndjeshme si pasojë e krizës globale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, për t'u rikthyer më pas në norma të larta rritjeje dhe për t'u stabilizuar në nivele më të moderuara gjatë viteve pasuese.

Ecuria Vjetore e PBB (vii/vit), 2009-2024																ne %
Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Ecuria	3,3	3,7	2,5	1,4	1,0	1,8	2,2	3,3	3,8	4,0	2,1	-3,96	8,54	4,84	3,94	4
Burimi: MFE, BSH, FMN, BB, INSTAT																

Vlerat absolute të Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 1999–2024, sipas tabelës së mëposhtme, tregojnë një tendencë të qartë rritjeje afatgjatë, duke reflektuar zgjerimin e dimensioneve të ekonomisë shqiptare. Ky zgjerim është një tregues i drejtpërdrejtë i bazës ekonomike mbi të cilën zhvillohen aktivitetet e sektorëve të ndryshëm, përfshirë ata që lidhen me shfrytëzimin e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit. Analiza e këtij trendi historik lejon një vlerësim më të saktë të potencialit të tregut dhe të ndikimit të tij në të ardhmen.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), 1999 - 2024																											miliard Leke
Renditja	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
PBB	506,2	523,3	583,3	622,7	694,1	750,8	814,8	882,2	966,6	1087,8	1,144,00	1,239,00	1,300,60	1,332,80	1,350,10	1,395,30	1,434,30	1,472,50	1,550,60	1,660,80	1,712,00	1,655,90	1,866,70	2,149,70	2,369,90	2,530,04	
Burimi: MF, BSH, INSTAT																											

5.3. Një dimension tjetër i rendësishëm i analizës lidhet me shpërndarjen rajonale të PBB-së, ku sipas të dhënave për periudhën 2017–2021 në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e secilit rajon në ekonominë kombëtare, duke ofruar një panoramë të qartë mbi kontributin relativ dhe zhvillimet specifike të tyre. Qarku i Tiranës dominon ndjeshëm me peshë ekonomike shumë më të lartë se qarqet e tjera, ndërkohë që qarqe si Durrësi, Fieri dhe Elbasani, ruajnë gjithashtu një rol të rendësishëm në krijimin e vlerës së shtuar kombëtare. Nga ana tjetër, rajonet më të vogla si Kukësi, Gjirokastra dhe Dibra paraqesin nivele më të ulëta të prodhimit.

Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente, 2017-2021					
Milion lek					
Rajoni	2017	2018	2019	2020	2021
Berat	58,833	58,547	57,883	57,835	62,201
Dibër	49,260	52,106	51,112	48,039	53,504
Durrës	156,857	162,378	171,576	163,631	186,709
Elbasan	105,598	110,379	111,830	112,749	124,976
Fier	165,990	178,368	188,442	179,915	201,532
Gjirokastrë	34,491	35,572	37,087	36,207	38,674
Korçë	84,713	87,837	90,725	88,767	96,586
Kukës	26,474	27,936	27,362	27,178	29,027
Lezhë	50,557	50,972	53,262	50,065	54,831
Shkodër	79,997	83,618	86,017	81,936	91,117

Tiranë	651,015	696,952	723,294	707,631	811,443
Vlorë	86,859	92,067	93,312	93,479	105,571
Gjithsej	1,550,644	1,636,732	1,691,902	1,647,432	1,856,171
<i>Burimi: INSTAT</i>					

Rritja e çmimeve në vitet e fundit ka ndikuar ndjeshëm jo vetëm në kostot e produkteve dhe shërbimeve, por edhe në vlerat mbi të cilat do të mbështetet llogaritja e tarifës së re për të drejtën e autorit. Për këtë arsye, është e nevojshme një analizë e kombinuar e treguesve realë dhe nominalë, në mënyrë që metodologjia të reflektojë saktë kushtet aktuale të tregut dhe tendencat e zhvillimit në çdo rajon.

Pesha e rajoneve sipas Produktit Brendshëm Bruto me çmime korente, 2017-2021					
	%				
Rajoni	2017	2018	2019	2020	2021
Berat	4%	4%	3%	4%	3%
Dibër	3%	3%	3%	3%	3%
Durrës	10%	10%	10%	10%	10%
Elbasan	7%	7%	7%	7%	7%
Fier	11%	11%	11%	11%	11%
Gjirokastrë	2%	2%	2%	2%	2%
Korçë	5%	5%	5%	5%	5%
Kukës	2%	2%	2%	2%	2%
Lezhë	3%	3%	3%	3%	3%
Shkodër	5%	5%	5%	5%	5%
Tiranë	42%	43%	43%	43%	44%
Vlorë	6%	6%	6%	6%	6%
<i>Burimi: INSTAT</i>					

Analiza e peshës së rajoneve në PBB-në kombëtare sipas çmimeve korente tregon një shpërndarje të qëndrueshme në kohë, me një dominim të dukshëm të qarkut të Tiranës, i cili kontribuon nga 42% deri në 44% të vlerës totale gjatë periudhës së shqyrtuar. Ky përqendrim tregon rolin e Tiranës si qendra kryesore ekonomike e vendit, ku përqendrohen aktivitetet më të mëdha tregtare, financiare, shërbimore dhe kulturore.

Qarqe të tjera si Durrësi dhe Fieri mbajnë një peshë të rëndësishme prej rreth 10–11% secili, për shkak të pozicionit strategjik në transport, logjistikë dhe industri. Ndërkohë, rajonet me peshë më të ulët si Kukësi, Dibra dhe Gjirokastra kontribuojnë vetëm 2–3% të PBB-së kombëtare, duke reflektuar një bazë ekonomike më të ngushtë dhe varësi më të madhe nga bujqësia dhe shërbimet lokale.

Përveç ndikimit të përgjithshëm që ka struktura rajonale në ekonominë kombëtare, është e nevojshme të analizohet edhe pesha specifike e sektorëve që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e të drejtës së autorit. Analiza e shpërndarjes së këtyre sektorëve sipas rajoneve (të dhënat e vitit 2022) tregon se: Tirana ka peshën më të lartë në tregti, transport, hoteleri dhe restorante (23%), si dhe në art, argëtimi dhe shplodhje (4%), duke konfirmuar rolin e saj si qendër kryesore e konsumit kulturor dhe turizmit urban. Qarqe si Durrësi, Vlora dhe Korça kanë gjithashtu kontribute të dukshme në këto sektorë, kryesisht për shkak të turizmit dhe aktiviteteve sezonale. Qarqet e tjera shfaqin peshë më të ulët, por në disa raste, kjo kompensohet nga rëndësia lokale e aktiviteteve, veçanërisht në sezonin turistik apo në evente të caktuara.

Prodhimi i brendshëm sipas Rajoneve, 2022													%
Sektorit	BR	DI	DR	EL	FR	GI	KO	KU	LE	SH	TR	VL	
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	48.6	41	15.3	39	47.9	28.1	43.2	38.1	30.3	29.9	3.6	27.3	
Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë Ndërtim	11	25.2	18.7	15.3	16.5	10.5	8.6	13.4	9.4	16.2	10.6	9.4	
Tregtia; Transport; Hotele	6.6	4.1	10.8	8.1	5.9	8.9	5.4	6.2	11.4	9.2	14.2	13.3	
Informacioni dhe komunikacioni	11.2	6.7	25.6	12.3	11.7	19.5	15.5	9	17.7	13.3	23	18.4	
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	1.4	1.3	1.2	1	0.9	2	1.4	1.7	1.4	1.6	6.3	1.7	
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	3	2.7	2.3	2	1.7	3.5	2.8	2.5	4	2.1	2.3	2.5	
Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike	3.3	3.1	9.5	5.1	3.9	4.2	5.4	4	6.5	6.9	7.3	8.9	
Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj.	1.3	1.7	6.3	2	2.7	3.9	1.6	1.3	2	3.2	12.1	3.9	
Arte, argëtim; çlodhje etj.	12.9	13.6	8.5	14	7.8	18.1	14.3	23.2	15.1	15.3	16.6	12.7	
	0.7	0.6	1.8	1.2	0.9	1.2	1.8	0.6	2.1	2.3	4	1.9	

https://www.instat.gov.al/media/11570/pbb-rajonale-2021-shqip_njoftim-per-media.pdf

<https://www.instat.gov.al/media/4639/material-metodologjik-llogaritë-rajonale.pdf>

Popullsia sipas rajoneve, 2023	
Qyteti	Numri
Berat	111,431
Dibër	106,380
Durrës	289,797
Elbasan	252,719
Fier	271,672
Gjirokastrë	53,314
Korçë	192,925
Kukës	71,498
Lezhë	114,181
Shkodër	189,164
Tiranë	925,268

Vlorë	183,436
Gjithsej	2,761,785
Burimi: INSTAT	

Të dhënat mbi popullsinë sipas rajoneve, për vitin 2023, japin një tregues të qartë të bazës së konsumatorëve potencialë për përdoruesit e të drejtës së autorit. Këta konsumatorë përfaqësojnë individë që, nëpërmjet shpenzimeve të tyre në sektorë si tregtia, shërbimet, prodhimi, hoteleria, restorantet dhe aktivitetet kulturore, ndikojnë drejtpërdrejt në përdorimin dhe shfrytëzimin e veprave të mbrojtura. Nga një vështrim krahasues, Tirana ka numrin më të madh të popullsisë që përfaqëson mbi 33% të popullsisë totale të vendit. Kjo e bën kryeqytetin jo vetëm tregun më të madh konsumator, por edhe qendrën kryesore ku përqendrohet potenciali më i madh ekonomik dhe kulturor.

Pas Tiranës, rajonet me popullsi të konsiderueshme janë Durrësi, Fieri dhe Elbasani, të cilat kanë një rëndësi strategjike për metodologjinë e tarifimit pasi, përveç madhësisë së popullsisë, ato kanë edhe sektorë ekonomikë të zhvilluar që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e të drejtës së autorit. Në këtë mënyrë, numri i popullsisë nuk është thjesht një tregues demografik, por një element kyç në ndërtimin e një sistemi tarifar të balancuar, që ruan raportin e drejtë midis mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe kapaciteteve reale ekonomike të përdoruesve në secilin rajon.

PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB) PËR BANOR NË SHQIPËRI, 2002 - 2023

PBB për frymë	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
PBB/Banor (Lek) ¹	197 063	200 653	224 495	260 241	278 453	298 493	397 541	386 643	429 697	466 250	452 667	451 813	520 312	500 583	529 081	510 009	573 345	593 258	596 886	659 744	736 741	986 592
Rritja LEK (vit/vit)	8,5%	1,8%	11,9%	15,9%	7,0%	7,2%	33,2%	-2,7%	11,1%	8,5%	-2,9%	-0,2%	15,2%	-3,8%	5,7%	-3,6%	12,4%	3,5%	0,6%	10,5%	11,7%	33,91%
PBB/Banor USD) ²	1425,1	1846,1	2373,6	2673,8	2972,7	3595,0	4370,5	4114,1	4094,3	4437,1	4247,6	4413,1	4578,6	3952,8	4124,1	4531,0	5287,7	5396,2	5332,2	6492,9	6789,0	9783
Rritja USD (vit/vit)	-99,2%	29,5%	28,6%	12,6%	11,2%	20,9%	21,6%	-5,9%	-0,5%	8,4%	-4,3%	-3,9%	3,8%	-13,7%	4,3%	9,9%	16,7%	2,1%	-1,2%	21,8%	4,6%	44,1%
PBB/Banor (Euro) ³	1436,5	1534,5	1771,2	2129,4	2250,3	2468,3	3226,7	2838,7	3095,3	3370,4	3238,8	3221,6	3714,6	3637,0	3912,9	3826,9	4653,2	4855,5	4888,6	5337,2	6412,2	9029,8
Rritja Euro (vit/vit)	-99,2%	6,8%	15,4%	20,2%	5,7%	9,7%	30,7%	-12,0%	9,0%	8,9%	-3,9%	-0,5%	15,3%	-2,1%	7,6%	-2,2%	21,6%	4,3%	0,7%	9,2%	20,1%	40,82%

¹ <https://www.instat.gov.al/statistika/AB-dh%3C%ABna-ty%3C%AJe/>

² <https://financa.gov.al/treguesit-e-borshit/>

³ <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=AL>

⁴ https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

Të dhënat e PBB-së për frymë tregojnë një rritje të dukshme të vlerës së prodhimit ekonomik për banor në terma nominalë, nga 197 mijë lekë në vitin 2002 në pothuajse 987 mijë lekë në vitin 2023. Rritjet më të forta vërehen në vitin 2008 (+33,2%), në 2022 (+11,7%) dhe veçanërisht në 2023 (+33,91%), ku ndikimi vjen si nga rritja ekonomike, ashtu edhe nga kursi i këmbimit, i cili ndjek të njëjtin drejtim, me rritje të forta në periudhat e zhvillimit ekonomik dhe ulje në periudha krize ose dobësimi të valutës. Ky tregues është themelor pasi ofron një pamje të qartë mbi fuqinë mesatare blerëse të popullsisë dhe kapacitetin e saj për të shpenzuar në sektorë ku e drejta e autorit zbatohet.

Paga minimale zyrtare (LEK/MUAJ)											Lek/Muaj	
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Paga minimale zyrtare	22,000	22,000	22,000	22,000	24,000	24,000	26,000	26,000	30,000	34,000	40,000	40,000
Burimi: MF, INSTAT												

Të dhënat në tabelën më lart tregojnë se paga minimale ka qëndruar e pandryshuar nga 2013 deri në 2016, më pas ka pësuar rritje graduale deri në 40,000 lekë në vitet 2023 dhe 2024. Rritja është veçanërisht e ndjeshme në periudhën 2021–2023 (+33,3% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2021), çka tregon një përpjekje për të rritur fuqinë blerëse të shtresave me të ardhura më të ulta, por shërben gjithashtu si tregues për të kuptuar kapacitetin bazik pagues të konsumatorëve.

Paga mesatare (sektori publik dhe privat) 2000 - 2020																				Lek	
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	24.4	29	34.5	37.2	37.55	44.3	51	59.2	60.5	71.5	73.5	76.5	81.7	82	82.4	82.8	83.5	84.4	86.5	87.5	88.8
Specialistë	18.2	20.2	23.1	26	27.02	29.9	33.4	39.1	42.5	50.3	55.3	58.9	60	60.8	61	61.2	61.6	62.5	64.4	68.6	70.1
Teknikë dhe ndihmës specialistë	13.5	16.3	18.3	19.4	20.05	24.5	25.9	31.3	33.6	40.7	43	45.3	46.3	47.3	47.4	48.7	49.1	55.1	56.8	56.7	59
Nëpunës të thjeshtë	14.4	15.6	17	20.3	21.25	23.9	24.2	27.8	29.6	34	36.2	37.9	40	41	41.1	42	42.4	48.9	51	52.1	54
Punëtorë	12.4	13.8	14.5	16.8	17.08	19.6	21.3	23.9	25.1	31.5	33.8	36	36.1	36.9	37.1	37.5	37.9	40	42.2	46.2	47.1
Paga mesatare	16.6	19	21.5	23.9	24.59	28.4	31.2	36.3	38.3	45.6	48.3	50.9	52.8	53.6	53.8	54.4	54.9	58.2	60.2	62.2	63.8
Burimi: INSTAT																					

Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve ekonomike

Grup-profesionet sipas ISCO-08	I 21	II 21	III 21	IV 21	I 22	II 22	III 22	IV 22	I 23	II 23	III 23	IV 23	I 24
Cjllëno	36,019	36,710	44,435	59,268	69,263	69,264	81,613	88,818	64,706	70,992	71,000	75,025	73,688
Manaxherë, Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	96.836	98.823	95.959	102.304	102.853	102.156	100.256	109.465	104.483	116.627	116.176	122.097	118.65
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	75.158	76.375	76.460	79.476	78.288	79.925	82.374	86.542	85.007	92.566	93.963	97.520	95.30
Teknikë dhe specialistë në zbatim	63.031	63.619	64.007	67.711	66.377	67.437	68.749	72.863	71.331	77.127	78.481	82.277	80.51
Nëpunësit	58.762	58.871	58.539	62.410	62.406	63.363	63.544	69.219	67.326	71.363	73.021	76.831	75.08
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	42.584	43.108	43.032	45.157	44.626	45.751	46.732	50.279	49.413	54.678	54.942	57.887	56.38
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	35.073	35.580	36.021	36.691	37.929	39.832	40.615	42.915	42.646	47.413	47.620	48.689	48.53
Zejtare, artizanë dhe profesionistë të lidhura me to	38.785	39.522	39.728	41.602	41.803	43.810	44.515	47.130	47.192	51.460	51.728	54.000	54.13
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinave dhe pajisjeve	38.995	39.632	40.241	42.514	42.760	45.495	46.253	49.272	48.958	52.924	53.223	55.950	55.36
Punëtorë (Profesione elementare)	32.454	34.295	34.747	35.097	36.281	38.620	39.402	41.572	41.387	46.387	47.029	48.368	48.13
Forcat e armatosura	64.495	65.705	65.232	65.287	70.493	65.359	77.362	78.837	79.568	86.236	86.454	87.172	86.33

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTA

Të dhënat tregojnë një rritje të vazhdueshme të pagave në të gjitha kategoritë, me diferencë të dukshme midis grupeve të punonjësve. Kategoria më e paguar janë ligjvënësit, drejtuesit dhe nëpunësit e lartë (88,8 mijë lek në 2020), ndërsa më të ultat janë pagat e punëtorëve (47,1 mijë lek në 2020). Paga mesatare për të gjithë punonjësit në vitin 2020 ishte 63,8 mijë lekë, me një tendencë të qëndrueshme rritjeje pas vitit 2015, duke pasqyruar një rritje të kapacitetit të konsumit.

Tabela e mëposhtme shërben për të evidentuar se në çfarë mase niveli i inflacionit ndikon në fuqinë reale së të ardhurave të konsumatorëve, duke reduktuar vlerën e tyre efektive për konsum dhe pjesëmarrje aktive në ekonomi. Ky tregues është i domosdoshëm pasi reflekton kushtet reale të tregut dhe kapacitetin ekonomik të konsumatorit në vendin ku ai ushtron veprimtarinë.

Ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit										%		
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Inflacioni	2.1	1.6	1.8	1.3	2	2	1.4	1.6	2	6.7	4.7	2,2
Burimi: BSH, INSTAT												

Të dhënat mbi shpërndarjen e vizitorëve sipas rajoneve në Shqipëri tregojnë një përqendrim të lartë të prurjeve turistike, si vendase ashtu edhe të huaja, në zonat me potencial të lartë ekonomik dhe kulturor. Qendra e vendit (përfshirë Tiranën dhe zonat përreth) ka numrin më të lartë të vizitorëve të huaj, duke e pozicionuar si destinacion kryesor për turizmin urban, biznesor dhe kulturor. Edhe vizitorët vendas janë të pranishëm në nivele të larta, duke konfirmuar rëndësinë e kësaj zone si qendër e konsumit të shërbimeve kulturore, argëtuese dhe komerciale.

Jugu i vendit tërheq një numër shumë të lartë vizitorësh vendas dhe një prani të konsiderueshme të vizitorëve të huaj, kryesisht për shkak të turizmit bregdetar, trashëgimisë kulturore dhe ngjarjeve sezonale. Veriu i vendit ka një peshë më të vogël, por gjithsesi reflekton potencialin në rritje të turizmit malor, natyror dhe kulturor. Përqendrimi i vizitorëve sipas rajoneve ka ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e potencialit ekonomik të përdoruesve së të drejtës të autorit. Rajonet që tërheqin një numër më të madh vizitorësh, sidomos të huaj, kanë një qarkullim më të lartë të të ardhurave nga turizmi dhe shërbimet.

Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj në Shqipëri sipas rajonit		
	Numër	
Rajoni	Vizitorë të huaj	Vizitorë vendas
Jugu i vendit	229,460	309,910
Qendra	410,030	237,323
Veriu i vendit	247,025	145,234
Gjithsej	886,515	692,467

Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas qëllimit dhe destinacionit, viti 2022

				%
Rajoni	Pushime	Vizita tek miqtë	Tjetër	Biznes
Berat	1.2	4.5	4.5	2.6
Dibër	0.5	6.4	2.6	18.3
Durrës	17.8	9.9	10.6	8.7
Elbasan	0.8	9.2	10.6	8.7
Fier	0.4	3.1	6.3	13
Gjirokastrë	1.4	5.1	0.1	0.8
Korçë	26	9.8	4.1	2.6
Kukës	1	3.8	2.7	0
Lezhë	2.7	11.4	1.9	0.4
Shkodër	3.4	4.7	1.4	6.3
Tiranë	10.4	28.9	61.7	28
Vlorë	34.3	3.2	2	17
<i>Burimi: INSTAT</i>				

Të dhënat në tabelën e mësipërme tregojnë një diferencim të qartë midis rajoneve për nga lloji i vizitës dhe lidhja e saj me konsumimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve tregtare dhe kulturore. Rajonet me përqindje të lartë të vizitave për pushime janë Vlora, Korça dhe Durrësi. Këto destinacione përfaqësojnë tregun kryesor për shfrytëzimin e veprave të mbrojtura në ambiente publike dhe tregtare, pasi vizitorët për pushime janë konsumatorë tipikë të hoteleve, restoranteve, bareve, aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.

Tirana ka një profil të veçantë, ku përveç përqindjes së konsiderueshme të vizitave për pushime, ka dominim të lartë në kategorinë “Tjetër” dhe për biznes. Kjo tregon për një treg më të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit, të lidhur me aktivitete ekonomike dhe evente jo-sezonale. Vizitat tek miqtë dhe të afërmit kanë peshë të lartë në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Lezhë, ndërsa rajonet si Dibra, Fier dhe Elbasani shfaqin përqindje të larta në vizitat për biznes dhe kategori të tjera, duke reflektuar një treg më të kufizuar turistik, por me prezencë të qëndrueshme të konsumatorëve për shkak të aktiviteteve ekonomike specifike.

Nëpërmjet tabelës së paraqitur më poshtë ofrohet një pasqyrë e qartë mbi shpërndarjen e udhëtimeve gjatë periudhave të vitit, duke evidentuar periudhat me intensitet të lartë si dhe ato me intensitet më të ulët. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar më mirë dinamikën e bizneseve që varen ngushtësisht nga kërkesa e klientëve vendas dhe, në mënyrë të veçantë, nga ajo e vizitorëve të huaj.

Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas tremujorit, viti 2022				
	%			
Rajoni	Tr. I	Tr. II	Tr. III	Tr. IV
Berat	4.1	3.3	6.8	5
Dibër	4.5	5.2	8.1	5.8
Durrës	8.7	6.9	5.6	14
Elbasan	10.5	10.7	12.1	9.9
Fier	5.4	7.5	6.6	8
Gjirokastrë	3	1.7	1	1.2
Korçë	4.7	5.1	6.3	5.4
Kukës	6.8	7	4.1	6.2
Lezhë	7.3	4.8	5.1	9.8
Shkodër	6.2	5.6	2.6	4.1
Tiranë	32.9	38.1	38.9	30.1
Vlorë	5.8	4.1	2.6	0.5
Burimi: INSTAT				

Duke analizuar nivelin e xhiros të secilit sektor të ekonomisë, të ndarë sipas rajoneve, bëhet e qartë jo vetëm shpërndarja gjeografike e aktivitetit ekonomik, por edhe potencialet reale të të ardhurave që mund të gjenerohen nga përdoruesit. Të dhënat tregojnë një përqendrim të dukshëm në qarkun e Tiranës, i cili dominon pothuajse në të gjithë sektorët, nga industria e deri tek teknologjia e informacionit, duke reflektuar rolin e tij si qendër kryesore ekonomike dhe financiare e vendit. Megjithatë, edhe qarqe të tjera si Durrësi, Fieri dhe Vlora paraqesin peshë të konsiderueshme në sektorë të caktuar, veçanërisht në tregti, transport dhe bujqësi, duke dëshmuar për diversifikimin rajonal së burimeve të të ardhurave.

Xhiro vjetore e ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik dhe qarqeve (në %), 2022								
Rajoni	Bujqësia dhe të tjera	Industria	Ndërtim	Tregtia	Transporti	Akomodimi	IT	
Berat	4.6	1.2	1	1.5	1.1	1.4	0.3	1.9
Dibër	0.7	1.7	1.8	0.9	0.6	0.9	0.4	1.4
Durrës	19.9	8.9	5.2	18.9	27.4	10.7	1.2	5.5
Elbasan	2.1	4	3.2	3	1.7	3.5	0.4	2.1
Fier	23.3	7	6	6.6	3.4	3.4	0.5	2.1
Gjirokastrë	1.1	0.9	1.2	3.5	1.2	1.1	0.1	1.7
Korçë	2.8	1.5	0.8	2.7	2.7	4.1	0.3	1
Kukës	0.1	0.3	0.6	1.2	0.4	0.7	0.1	1.4
Lezhë	3.4	1.2	2.2	2.1	1.2	5.7	0.2	2

Shkodër	9.9	2.1	2.5	2.6	1.5	3.9	1	2
Tiranë	18	69.7	70.1	53.7	56	50.8	94.7	76.1
Vlorë	13.9	1.5	5.4	3.4	2.8	13.9	0.9	2.8
Burimi: INSTAT								

5.4 Të dhënat e mëtejshme mbi numrin e njësisve akomoduese dhe numrin e dhomave, të cilat përbëjnë një segment të rëndësishëm të përdoruesve së të drejtës së autorit, na mundësojnë një analizë më të thelluar të potencialit ekonomik të këtij sektori. Duke marrë parasysh se akomodimi është i ndërthurur ngushtë me ofrimin e shërbimeve që përdorin veprat e mbrojtura, integrimi i këtyre të dhënave me informacionin mbi xhiron e sektorëve të tjerë lejon një vlerësim më të plotë të mundësive reale të tregut dhe të kontributit që ky segment sjell në ekonominë e përgjithshme të aktivitetëve të mbuluara nga e drejta e autorit.

Numri mesatar i dhomave të disponueshme dhe numri mesatar i dhomave të zëna sipas rajonit		
Rajoni	Viti 2022	
	Dhoma të zëna	Dhoma gjithsej
Jugu i vendit	43,414	217,200
Qendra	58,270	292,403
Veriu i vendit	29,897	185,679
Gjithsej	131,581	695,282
Burimi: INSTAT		

Të dhënat mbi numrin mesatar të dhomave të disponueshme dhe të zëna sipas rajoneve në tabelën më sipër, japin një tregues të qartë të kapacitetit akomodues dhe shkallës së shfrytëzimit të tij. Në vitin 2022, rajoni qendror i vendit ka regjistruar numrin më të lartë të dhomave të zëna, duke reflektuar një aktivitet të qëndrueshëm akomodues që mbështet turizmin urban dhe atë të biznesit. Jugu i vendit, me 43,414 dhoma të zëna nga 217,200 gjithsej, tregon një përdorim intensiv gjatë sezonit turistik, ndërsa rajoni verior i vendit paraqet një kapacitet më të kufizuar, duke e lidhur atë me një profil më sezonal dhe me të orientuar drejt turizmit malor dhe natyror.

Numri i strukturave akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra) sipas qarkut, 2020 – 2022		
Rajoni	Nomer	
	2021	2022
Berat	49	49
Dibër	23	28

Durrës	110	135
Elbasan	52	58
Fier	45	48
Gjirokastrë	52	55
Korçë	110	115
Kukës	21	23
Lezhë	72	78
Shkodër	150	150
Tiranë	400	410
Vlorë	330	390
Burimi: INSTAT		

Të dhënat mbi numrin e strukturave akomoduese për periudhën 2021–2022 tregojnë një rritje të lehtë në shumicën e qarqeve, me rritje të dukshme në qarqe me potencial turistik të lartë si Durrësi, Vlora dhe Tirana. Ky zgjerim i kapacitetit akomodues reflekton rritjen e kërkesës, por edhe shkallën e shfrytëzimit të strukturave akomoduese gjatë vitit.

REGJISTRI I TATIMPAGUESVE SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

ml

n. Leke

Nr.	Kodi nga deri	Përshkrimi	Mikro 0 - 5 million	I Vogël 5 - 5 million	I Mesëm 5 - 180 million	I Madh mbi 180 million	Gjithë
1	0100 0499	SEKSIONI A: BUIQËSIA, GIUETIA DHE SILVIKULTURA	1,101	13	77	4	1,1
2	0500 0999	SEKSIONI B: PESHKIMI	978	4	22	0	1,0
3	1000 1299	NËNSEKSIONI CA: NXJERRJA E PRODUKTEVE ENERGJITIKE	108	4	27	8	1
4	1300 1499	NËNSEKSIONI CB: NXJERRJA E PRODUKTEVE JO ENERGJITIKE	345	8	125	7	4
5	1500 1699	NËNSEKSIONI E	3,517	45	165	29	3,7
6	1700 1899	NËNSEKSIONI DB: INDUSTRIJA TEKSTILE DHE E VESHJEVE	480	13	167	1	6
7	1900 1999	NËNSEKSIONI DC: INDUSTRIJA E LEKURËS DHE E KËPUCËVE	63	2	54	6	1
8	2000 2099	NËNSEKSIONI DD: PUNIMET ME DRU DHE FABRIKIMI I ARTIKUJVE PREJ DRURI	843	11	64	0	9
9	2100 2299	NËNSEKSIONI DE: FABRIKIMI I BRUMIT TË LETRËS, I LETRËS DHE ARTIKUJVE PREJ LETRE	495	29	112	6	6
10	2300 2399	NËNSEKSIONI DF: RAFINIMI I NAFTES, KOKSIFIKIMI, INDUSTRIJA NUKLEARE	8	1	2	0	
11	2400 2499	NËNSEKSIONI DG: INDUSTRIJA KIMIKE	102	12	65	7	1
12	2500 2599	NËNSEKSIONI DH: INDUSTRIJA E KAUCUKUT DHE E PLASTIKËS	105	10	27	0	1
13	2600 2699	NËNSEKSIONI DI: FABRIKIMI I ARTIKUJVE TË TJERË MINERALE JO METALIKE	475	20	141	32	6
14	2700 2899	NËNSEKSIONI DJ: METALURGJIA DHE PUNIMI I METALEVE	1,030	21	116	14	1,1
15	2900 2999	NËNSEKSIONI DK: FABRIKIMI I MAKINAVE DHE PAJISJEVE	52	4	20	0	
16	3000 3399	NËNSEKSIONI DL: FABRIKIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE	66	5	24	3	
17	3400 3599	NËNSEKSIONI DH: FABRIKIMI I MJETEVE TË TRANSPORTIT	40	1	7	0	

18	3600	3999	NENSEKSIONI DN: INDUSTRI TË TJERA PËRPUNUESE	1,033	31	86	6	1,1
19	4000	4499	SEKSIONI E: PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE, GAZIT DHE UJIT	326	13	79	11	4
20	4500	4999	SEKSIONI F: NDËRTIMI	3,678	202	1,421	194	5,4
21	5000	5499	SEKSIONI G: TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË. RIPARIMI I AUTOMOBILEVE DHE I PAJISJEVE SHËTËPAKE	49,578	722	3,902	350	54,5
22	5500	5999	SEKSIONI H: HOTELET DHE RESTORANTET	18,899	102	234	11	19,2
23	6000	6499	SEKSIONI I : TRANSPORTET DHE KOMUNIKACIONI	10,396	71	388	49	10,9
24	6500	6999	SEKSIONI J: NDËRMJETËSIMI FINANCIAR	710	23	46	32	8
25	7000	7499	SEKSIONI K: PASURITË E PATUNDSHME, DHENIA ME QERA, DHE SHËRBIMET KUNDREJT NDËRRMARJEVE	7,663	161	479	46	8,3
26	7500	7999	SEKSIONI L: ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES; SIGURIMI SHOQËROR I DETYRUAR	1,971	26	100	3	2,1
27	8000	8499	SEKSIONI M: ARSIMI	811	26	56	5	8
28	8500	8999	SEKSIONI N: SHËNDETI DHE VEPRIMTARITË SOCIALE	2,400	18	34	2	2,4
29	9000	9499	SEKSIONI O: AKTIVITETE TË TJERA TË SHËRBIMIT KOLEKTIV, SIGURIMI SHOQËROR I DETYRUAR	8,397	44	199	18	8,6
30	9500	9899	SEKSIONI P: SHËRBIMI SHËTËPAK	97	0	1	0	
31	9900	9999	SEKSIONI Q: AKTIVITETE TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARE	114	0	6	0	1
32	0	0	AKTIVITETE TË TJERA*	90	1	1	0	
Numri i tatimpaguesve sipas Regjistrat Kombëtar të Tatimpaguesve				115,971	1,643	8,247	844	126,7

Shënim: Në segmentin (0-5) regjistrohen gjithë ata që nuk janë të grupet e tjera

* Në grupin e 32. përfshihen gjithë kodet ekonomike që nuk mund të regjistrohen në të tjera, për shkak gabime regjistrimi, moskodifikim etj. Nga QKB

5.5. Të dhënat në tabelën e mësipërme pasqyrojnë shpërndarjen e bizneseve sipas sektorëve të ekonomisë dhe madhësisë së tyre (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha). Tabela tregon se pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve shqiptare janë mikro-biznese (me xhiro deri në 5 milion lekë), të cilat përbëjnë mbi 90% të totalit të regjistruar. Ky realitet tregon për një ekonomi të ndërtuar mbi një bazë të gjerë njësisish të vogla, me kapacitet të kufizuar investimi dhe me ndikim modest në nivel makroekonomik, por që mbajnë gjallë aktivitetin ekonomik të përditshëm.

Sektori dominues është tregtia me shumicë dhe pakicë, me mbi 54 mijë tatimpagues, duke reflektuar rolin e këtij sektori si shtylla kryesore e qarkullimit ekonomik. Pas tij, renditen akomodimi, shërbimi ushqimor dhe ndërtimi. Ky konfigurim tregon qartë orientimin e ekonomisë shqiptare drejt tregtisë dhe shërbimeve, ndërsa sektorë të tillë si industria përpunuese, energjia apo ndërmjetësimi financiar kanë numër dukshëm më të kufizuar aktorësh.

Në anën tjetër, ndërmarrjet e mëdha janë të pakta, por të përqendruara në sektorë strategjikë si industria ushqimore, metalurgjia, energjia dhe ndërmjetësimi financiar. Kjo strukturë dëshmon se peshën kryesore në të ardhurat kombëtare e mbajnë disa ndërmarrje të mëdha, ndërsa baza e gjerë e mikrondërmarrjeve siguron diversitet dhe shtrirje të ekonomisë në çdo rajon.

Numri bizneseve sipas rajoneve, 2022							
Rajonet	Gjithësej biznese	Prodhuësit dhe Ndërtuesit	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera

Berat	4,027	3,411	1,712	218	704	61	716
Dibër	2,207	1,782	856	114	361	34	417
Durrës	12,721	10,544	4,813	738	1,574	287	3,132
Elbasan	7,673	6,541	2,921	480	1,363	151	1,626
Fier	9,564	8,143	4,262	460	1,453	136	1,832
Gjirokastrë	2,515	2,127	905	175	474	42	531
Korçë	6,167	5,343	2,484	440	1,088	110	1,221
Kukës	1,342	1,146	448	90	264	25	319
Lezhë	4,281	3,619	1,622	197	792	62	946
Shkodër	6,315	5,494	2,490	214	1,108	187	1,495
Tiranë	58,828	52,016	18,314	2,389	6,093	3,608	21,612
Vlorë	9,582	8,114	3,058	531	2,178	169	2,178
TOTAL	125,222	108,280	43,885	6,946	17,452	4,872	36,025
<i>Burimi: INSTAT, DPT</i>							

Kjo tabelë paraqet shpërndarjen e bizneseve në nivel rajonal. Këtu evidentohet qartë dominimi i Tiranës, e cila me mbi 58 mijë biznese përfaqëson gati gjysmën e totalit kombëtar. Ky përqendrim lidhet me faktin që kryeqyteti është qendra kryesore financiare, administrative dhe tregtare e vendit, si dhe vendi ku gjenerohen aktivitetet më të mëdha në fushën e shërbimeve dhe informacionit.

Pas Tiranës, qarqet më aktive janë Durrësi, Fieri dhe Vlora, të cilat kanë zhvillim të spikatur në tregti, transport, turizëm dhe shërbime. Pozita gjeografike dhe infrastruktura portuale u jep këtyre rajoneve një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Ndërsa, qarqe si Dibra, Kukësi dhe Gjirokastra kanë numër dukshëm më të ulët biznesesh, me një strukturë më të përqendruar në bujqësi dhe shërbime bazike, duke treguar potencial të kufizuar ekonomik.

Nga ana sektoriale, tregtia mbetet aktiviteti më i madh në çdo rajon, duke u ndjekur nga ndërtimi dhe transporti në zonat urbane dhe bregdetare, si dhe nga akomodimi e shërbimi ushqimor në rajonet turistike. Ky diferencim gjeografik tregon se kapacitetet e ekonomisë shqiptare janë të përqendruara në disa zona të veçanta, ndërsa rajonet e tjera mbeten periferike dhe më pak konkurruese.

VI. ARSYETIM I METODOLOGJISË DHE MASËS SË TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIVOBJEKTI DHE QËLLIMI

6.1. Shqipëria ka ndërmarr hapa të rëndësishëm në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to. Megjithatë, sfida të ndryshme mbeten dhe pengojnë funksionimin efikas të sistemit. Kjo e bën të nevojshme hartimin e një metodologjie të

qartë dhe të unifikuar, që siguron tarifa transparente, koherente, konkurruese dhe jo-abuzive për subjektet, çka do të nxisë subjektet përdoruese për të paguar në mënyrë të rregullt ato.

Tarifat për përdorimin e veprave dhe të drejtave të autorit përbëjnë një komponent të rëndësishëm të sistemit të administrimit kolektiv, pasi ato përbëjnë burimin kryesor të shpërblimit që u shpërndahet mbajtësve së të drejtave. Për miratimin e këtyre tarifave, përcaktohet jo vetëm vlera/tarifa përkatëse që duhet të paguhet për përdorimin e të drejtave të mbrojtura, por edhe metodologjia e llogaritjes dhe pagesës së tyre nga çdo subjekt përdorues në favor të agjencive të administrimit kolektiv ("AAK") për veprat dhe të drejtat që këto agjenci përfaqësojnë dhe administrojnë.

6.2. Metodologjia për përcaktimin e masës dhe tarifave të shpërblimit për veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit në kuadër të administrimit kolektiv ("**Metodologjia**") është hartuar mbështetur në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të", i ndryshuar, dhe synon respektimin e të drejtave të secilës palë që i adresohet, duke siguruar në mënyrë të plotë balancën midis të drejtave të subjekteve përdoruese, të drejtave të mbajtësve së të drejtave dhe interesit publik për informim, si dhe klimës së përshtatshme të biznesit. Përcaktimi i tarifave bazohet në kritere objektive dhe të justifikuara mbështetur në faktorë të qartë, të drejtë dhe të justifikueshëm.

6.3. Qëllimi parësor i Metodologjisë është që, nëpërmjet tarifave gjithëpërfshirëse, të pajtojë interesat e mbajtësve së të drejtave me ato të përdoruesve përmes krijimit të një sistemi të balancuar shpërblimi. Po ashtu, një sistem i tillë i mirëstrukturuar jo vetëm që fuqizon të drejtat e autorëve dhe mbajtësve së të drejtave, por siguron edhe transparencë dhe parashikueshmëri për përdoruesit duke ndihmuar në krijimin e një klime të qëndrueshme ligjore për investime kulturore dhe zhvillimin e industrive kreative.

Për më tepër, Metodologjia ka për qëllim të ulë nivelin e informalitetit në këtë fushë, nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe bashkërenduese. Në këtë kontekst, ajo synon të përmirësojë procesin e llogaritjes dhe të mbledhjes së tarifave për përdorimin e veprave të mbrojtura. E konceptuar si një instrument praktik që synon të lehtësojë strukturën ekzistuese të tarifave dhe të zgjerojë bazën e përdoruesve që kontribuojnë financiarisht për përdorimin e veprave të mbrojtura, në përputhje me parimet e drejtësisë, paanshmërisë dhe barazisë, proporcionalitetit dhe transparencës.

Në këtë mënyrë, ajo synon një zbatim të njëtrajtshëm dhe të qëndrueshëm të legjislacionit në fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar zgjidhje praktike bazuar edhe në sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura nga grupet e interesit, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të drejtë, proporcionale dhe të përballueshme për të gjitha palët e përfshira. Në çdo rast, tarifat nuk janë të pandryshueshme. Ato rishikohen në mënyrë të rregullt për të reflektuar ndryshimet në treg, në mënyrat e përdorimit të veprave dhe në kushtet ekonomike.

6.4. Njëkohësisht, Metodologjia është konceptuar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Duke mbajtur në konsideratë relativitetin e tyre, kjo Metodologji synon përafrimin me modelet e vendeve me kushte të ngjashme ekonomiko-sociale me Shqipërinë, të tilla si: Bullgaria, Greqia, Rumania, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kroacia. Modeli ligjor i pjesës më të madhe të këtyre shteteve ka shërbyer edhe në modelimin e vetë LDA-së.

6.5. Së fundmi, Metodologjia mbështetet në parimet ndërkombëtare dhe ato të aplikuara në Bashkimin Evropian, sidomos ato të përfshira në nenin 16(2), nënparagrafi 2 i Direktivës 2014/26/EU², në vendosjen e kriterave objektive dhe jo-diskriminuese në përcaktimin e tarifave për shëprblimin e përdorimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit. Kjo vjen edhe në kuptim dhe zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga MSA-ja dhe negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian lidhur me kapitullin 7 - "E drejta e pronësisë intelektuale".

1. MBI TË ARDHURAT BRUTO DHE PËRQINDJEN

6.6. Kriteri bazë i përdorur për përllogaritjen e tarifave në këtë Metodologji është zëri i të ardhurave bruto të realizuara nga subjektet përdorues si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të lidhura, sipas parimit "kush përdor paguan", i cili është ruajtur si praktikë edhe nga Metodologjia Nr. 3 datë 04.08.2017, e ndryshuar. Zgjedhja për të vijuar me këtë kriter mbështetet në parimet dhe kriteret e parashikuara në LDA-në si dhe natyrën e tij të besueshme, të matshme dhe të verifikueshme, ashtu si edhe në aftësinë për të garantuar një trajtim të barabartë dhe proporcional ndërmjet subjekteve përdoruese. Për më tepër, ky kriter është i njohur, i pranuar dhe i zbatuar tashmë nga subjektet përdoruese—veçanërisht nga ato të kategorisë së parë—çka dëshmon për stabilitetin dhe vazhdimësinë në zbatimin e tij.

Megjithatë, të ardhurat e arkëtuara nga SUADA dhe numri i subjekteve përdoruese që kanë marrë autorizim përdorimi për veprat e mbrojtura, sidomos referuar vitit të fundit, ka pësuar rënie.

Tabela 1. Të ardhurat e arkëtuara nga SUADA për periudhën 2022-2024

Viti	Të ardhura totale (Lek)	Numri i subjekteve të autorizuar
2022	60,090,574	268 autorizime
2023	75,815,991	268 autorizime
2024	42,539,255.48	206 autorizime

Këto të dhëna përfshijnë të ardhurat totale të mbledhura dhe numrin e subjekteve të autorizuar për secilin vit. Analiza e këtyre treguesve përbën një element thelbësor për vlerësimin e performancës aktuale të sistemit të mbledhjes së të ardhurave në administrimin kolektiv, identifikimin e tendencave në pagesën e tarifave dhe përcaktimin e problematikave kryesore që kërkojnë adresim përmes një metodologjie më efektive dhe të qëndrueshme. Një ndër çështjet kryesore, që është ngritur si shqetësim nga grupet e interesit dhe kërkon adresim, lidhet me zërin e të ardhurave bruto dhe përqindjen që rëndon mbi të.

6.7. Në këtë drejtim, KKDA-ja shqyrtoi me vëmendje qëndrimet, mendimet, shpjegimet dhe/ose pretendimet e palëve të paraqitura me shkrim dhe të depozituara pranë sekretariatit të KKDA-së, të cilat janë të përmbledhura si më poshtë vijon:

² Directive 2014/26/EU of the European Parliament and of the Council of 26 February 2014 on collective management of copyright and related rights and multi-territorial licensing of rights in musical works for online use in the internal market Text with EEA relevance *OJ L 84, 20.3.2014, pp. 72–98* ELI: <http://data.europa.eu/eli/dir/2014/26/oj>

1. **Një grup prej pesë subjektsh televizive – Digitalb, Top Channel, Tring, TV Klan dhe Media Vizion** kanë shprehur dhe mbajtur qëndrime të unifikuara lidhur me projekt-metodologjinë e tarifave të përgatitur nga ekspertët e caktuar me këtë detyrë. Këto subjekte theksojnë rëndësinë e një metodologjie të drejtë dhe të zbatueshme në kushtet e tregut shqiptar, duke propozuar që tarifa të mbetet në nivelin 1.3% mbi të ardhurat bruto, të zhveshura nga të ardhurat që nuk lidhen me të drejtën e autorit, sipas interpretimit të tyre për përjashtimet.

Ndër shqetësimet e ngritura renditet mosrespektimi i praktikave të mëparshme të dakorduara me KKDA-në dhe mungesa e konsiderimit të realitetit rajonal, duke vënë në dukje se krahasimi me tregjet e vendeve të BE-së është i papërshtatshëm. Ata propozojnë që referenca të merret nga praktika e vendeve fqinje me struktura të ngjashme tregu. Po ashtu, ngrihen shqetësime se tarifimi aktual mund të rëndojë vetëm përdoruesit korrektë, ndërkohë që mungojnë masa për të zgjeruar bazën e përdoruesve që paguajnë. Për më tepër, vihet në dukje mungesa e transparencës në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave të mbledhura, si dhe nevoja për të trajtuar në mënyrë të diferencuar veprat e krijuara në marrëdhënie pune. Qëndrimet e këtyre pesë subjekteve janë të njëjta në thelb dhe kërkojnë një qasje të drejtë, të balancuar dhe të zbatueshme për të gjitha palët e përfshira.

2. **Subjekti Smart Solutions** paraqet vërejtje lidhur me faktin se metodologjia aktuale nuk është rishikuar rregullisht dhe nuk është e pranuar nga të gjitha palët, duke mbështetur një sistem më të drejtë dhe më transparent, si dhe përfshirjen e tarifave për shërbime digjitale dhe kopje private.
3. **Subjektet Vodafone Albania dhe One.al** theksojnë domosdoshmërinë për të përfshirë përjashtime të qarta dhe të justifikuara nga të ardhurat bruto. Sipas tyre, përlllogaritja e tarifave duhet të bazohet vetëm në të ardhurat që burojnë drejtpërdrejt nga përdorimi i veprave të mbrojtura, duke përjashtuar të ardhura që lidhen me aktivitete të tjera tregtare (si reklamat e brendshme, shitja e produkteve, pagesat për përdorim të drejtpërdrejtë nga autori apo nga jashtë territorit shqiptar), pasi në të kundërt do të cenohej parimi i drejtësisë dhe proporcionalitetit.

Për më tepër, një pjesë e rëndësishme e komenteve të Vodafone Albania lidhet me kundërshtimin ndaj pretendimeve se marrëdhëniet kontraktore individuale ndërmjet autorit dhe përdoruesit nuk janë të lejuara, duke argumentuar se legjislacioni në fuqi e lejon qartë këtë praktikë dhe kontrata të tilla janë të vlefshme e prodhojnë pasoja juridike. Ata theksojnë se pagesat e kryera sipas këtyre kontratave duhet të përjashtohen nga baza e llogaritjes së tarifës, pasi autori është tashmë i shpërblyer.

4. **AAK-ja “F.A.A.D”** thekson se projekt-metodologjia e tarifave nuk reflekton realitetin shqiptar dhe injoron një parim themelor ndërkombëtar: shpërblymi i drejtë për çdo formë përdorimi të veprës. Sipas tyre, në rastet kur një televizion transmeton përmes më shumë se një kanali (si DVB-T2, satelit, aplikacione VOD apo platforma të tjera), çdo mënyrë shtesë përdorimi duhet të përfshijë një tarifë të rritur për të respektuar të drejtën e autorëve për një shpërblym të drejtë dhe proporcional me përdorimin.

Për këtë arsye, FAAD propozon një mekanizëm tarifor ku forma bazë e transmetimit të tarifohet me çmimin fillestar, ndërsa çdo formë tjetër shtesë të sjellë rritje në tarifë — 10% për formën e dytë dhe 2% për çdo formë pasuese. Ky propozim ka për qëllim të shmangë abuzimin dhe të sigurojë që përdoruesit të mos përfitojnë nga përdorimi shumëformatësh i veprave pa një shpërblim të drejtë për titullarët e të drejtave. F.A.A.D gjithashtu kërkon që çdo subjekt përdorues të paguajë detyrimisht paraprakisht të paktën 70% të tarifës së përcaktuar, pavarësisht nëse ka kundërshtime apo çështje të hapura ligjore. Ata theksojnë se sistemi aktual lejon përdoruesit të shtyjnë pagesat përmes gjykatave, ndërkohë që vijnë të përdorin veprat në mënyrë të pandërprerë, duke mbajtur autorët "peng" ekonomikisht. Për këtë arsye, ata kërkojnë që këto ndryshime të përfshihen në metodologjinë përfundimtare për të garantuar mbrojtje efektive të të drejtave të autorit.

5. AAK-ja “Albautor” në qëndrimin e saj mbi draft-metodologjinë e tarifave, ka adresuar çështje që lidhen me përkufizimin e të ardhurave bruto dhe përmbajtjen e strukturës tarifore, si më poshtë vijon:

5.1. Albautor kundërshton përjashtimin nga përlllogaritja e të ardhurave bruto të përjashtimeve të vetme nga të ardhurat të parashikuara në draft-metodologjinë e përgatur nga ekspertja ndërkombëtare: (a) të ardhurat nga prodhimi i programeve të porositura që kalojnë në pronësi të porositësit, dhe (b) rimarrja e shumës së paguar për të drejtat ekskluzive të transmetimit të ngjarjeve sportive.

Sipas tyre, këto përjashtime janë të pajustificueshme dhe bien ndesh me LDA dhe legjislacionin për median audiovizive, pasi reduktojnë padrejtësisht bazën mbi të cilën përlllogaritet tarifa për përdorimin e veprave të mbrojtura.

Në thelb, çdo formë transmetimi publik e një vepre të mbrojtur përbën një akt komunikimi në publik dhe ngarkon subjektin transmetues (OSHMA-në) me detyrimin ligjor për të marrë autorizim nga agjencitë e administrimit kolektiv dhe për të paguar tarifën përkatëse.

Përjashtimi i të ardhurave që lidhen me programe të porositura apo ngjarje sportive, pavarësisht marrëdhënieve kontraktore ndërmjet palëve, krijon një precedent të rrezikshëm që lejon përdorimin komercial të veprave pa shpërblimin e duhur për autorët.

Albautor argumenton se koncepti i të ardhurave bruto duhet të bazohet në parimet e së drejtës së autorit dhe jo në kritere thjesht financiare apo kontabël. Përfshirja e çdo të ardhure që rrjedh nga transmetimi i veprave të mbrojtura është thelbësore për të garantuar një shpërblim të drejtë dhe proporcional për autorët.

Përjashtimet e propozuara, sipas tyre, dobësojnë mekanizmin e administrimit kolektiv dhe cenojnë mbrojtjen e interesave të ligjshëm të krijuesve.

5.2. Në vijim, Albautor ka paraqitur vërejtjet e saj përfundimtare mbi draft-metodologjinë e tarifave, duke adresuar çështje që lidhen me përkufizimin e të

ardhurave bruto dhe përmbajtjen e strukturës tarifore, duke paraqitur edhe një sërë sugjerimesh konkrete në lidhje me përmirësimin e strukturës së tarifave të reja:

Së pari, kërkohet të hiqet çdo referencë ndaj nenit 69 të LDA-së në tabelat përkatëse, pasi përmendja e dispozitës që lidhet me autorësinë e veprave të krijuara në marrëdhënie pune nuk ka vend në skemën tarifore dhe mund të interpretohet si një formë udhërrëfimi për shmangie të detyrimeve;

Së dyti, në rastin e televizioneve kablllore, Albautor propozon zëvendësimin e ndarjes sipas kohëzgjatjes me një tarifë fikse prej 2.5–3% së të ardhurave bruto, duke qenë se përqindja e veprave të mbrojtura në këto transmetime i tejkalon kufijtë e parashikuar aktualisht;

Së treti, për strukturat akomoduese, kritikohet aplikimi i një tarife degresive për subjektet e kategorisë së lartë. Sipas Albautor, vepra merr më shumë vlerë në mjedise që vetë kanë një vlerë të shtuar, prandaj ulja e tarifës për këto struktura është në kundërshtim me logjikën ekonomike të shpërblimit të drejtë;

Së katërti, kërkohet sqarimi i mënyrës së përlllogaritjes së tarifës në bazë të metrave katrorë, duke ndryshuar formulimin në “pikë/muaj/m²” për të shmangur keqinterpretime; dhe

Së fundi, për ngjarjet kulturore që nuk funksionojnë me sistem biletash, propozohet shtimi i referencës ndaj “shpenzimeve të organizimit” si bazë për përlllogaritje, me mundësi modulimi të përqindjes në raste të veçanta (p.sh. 5%).

Qasjet e mësipërme janë artikuluar edhe më parë, si dhe janë analizuar në Draft Raportin e Metodologjisë të përgatitur nga ekspertja ndërkombëtare, ku subjektet përdoruese kanë mbajtur qëndrimin që tarifa të jetë në nivelin 1.3% mbi të ardhurat bruto, të zhveshura nga të ardhurat që nuk lidhen me të drejtën e autorit, ndërsa AAK-të propozojnë të ardhura bruto pa përjashtime dhe masën 2.5% -3% që rëndon mbi to.

Lidhur me sa më sipër, KKDA-ja vlerëson se pretendimet e AAK-ve dhe përdoruesve janë në skaje të kundërta dhe vendosi të mbajë një qasje të balancuar dhe neutrale bazuar mbi këto kërkesa, me qëllim garantimin e një procesi transparent duke përdorur logjikën e një simetrie ekonomike, dhe duke miratuar një tarifë të ndërmjetme, e cila qëndron midis nivelit minimal të kërkuar nga përdoruesit dhe nivelit maksimal të kërkuar nga AAK-të. Kjo ofron një qasje të përshkallëzuar në varësi të peshës së veprës së mbrojtur në programacion (për Kategorinë I). Kjo normë, e aplikuar pa asnjë përjashtim mbi të ardhurat bruto, garanton një shpërblim të drejtë për autorët dhe një kosto të përballueshme për subjektet përdoruese.

Tarifat e përcaktuara në Metodologji janë më të ulëta se në vendet e rajonit dhe vendet e tjera me standard të përafërt zhvillimi ekonomiko-social me Republikën e Shqipërisë, bazuar në të dhënat e analizuar për secilin vend.

Përmes tarifave më të ulëta, KKDA-ja synon të ofrojë një qasje proporcionale duke arritur tre objektiva:

*(i) të respektojë kriteret ligjore të nenit 142 e 149 të LDA-së,
(ii) të sigurojë një mjedis ekonomikisht të përballueshëm për subjektet përdoruese në Republikën e Shqipërisë; dhe*

(iii) të garantojë të ardhura më të qëndrueshme për mbajtësit e të drejtave, duke garantuar një shpërblim të drejtë dhe të arsyeshëm për çdo formë shfrytëzimi apo përdorimi të të drejtave të tyre.

Në këtë vendimmarrje, KKDA-ja është udhëhequr edhe nga parimi se një tarifë më e ulët, por e paguar nga më shumë subjekte, sjell më shumë të ardhura reale, duke përmirësuar edhe funksionimin e administrimit kolektiv në vend.

Siç rezulton nga të dhënat zyrtare të SUADA-s (*shih Tabela 1 më sipër*), të ardhurat bruto nga tarifat ranë ndjeshëm: nga 75,8 milion lek në 2023 në vetëm 42,5 milion lek në 2024, ndërkohë që numri i autorizimeve zbriti nga 268 në 206. Siç është raportuar edhe nga SUADA në takimet konsultuese me KKDA-në në kuadër të hartimit të Metodologjisë, numri i autorizimeve vazhdon të jetë i ulët, duke nënkuptuar se të drejtat e autorit në Shqipëri përdoren në mënyrë të paautorizuar në një masë të madhe. Ky tregues nënvizon nevojën për një sistem tarifor që të jetë më i thjeshtë, më i drejtë dhe më nxitës për zbatueshmëri.

Pavarësisht se marrja e autorizimeve dhe mbledhja e tarifave nuk është kompetencë e drejtpërdrejtë e KKDA-së, vlerësohet se tarifat e miratuara sipas metodologjisë aktuale mund të rëndojnë problemet sistematike të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

Ulja e të ardhurave të mbledhura nga SUADA evidenton dy probleme:

- (i) tarifat ekzistuese mund të jenë të larta krahasuar me fuqinë paguese të tregut; dhe*
- (ii) evazoni apo mospagesa rritet, duke dëmtuar të gjithë sistemin edhe vetë krijesit.*

Rrjedhimisht, ulja e nivelit nominal synon të zgjerojë bazën e subjekteve paguese, duke sjellë më shumë të ardhura neto afatgjata. Nga ana tjetër, në këtë arsyetim, tarifat nuk përbëjnë barrë për paguesit aktualë, si sektori mediatik (që përbëjnë 72,88% të përdoruesve sipas të dhënave të SUADA, për vitin 2024), dhe marrin në konsideratë dinamikat e tregut shqiptar, me vëmendje të posaçme të subjektet përdorues të vogla dhe të mesme (që dominojnë tregun), duke qenë kështu edhe më të ulëta se në vende si Greqia apo Kroacia.

Nga ana tjetër, KKDA-ja vlerëson se Metodologjia nr. 3, datë 04.03.2017, e ndryshuar, e cila zbatonte një përqindje më të lartë, por lejonte zbritje të ndryshme nga të ardhurat bruto, e komplikon procesin e mbledhjes së tarifave. Si rregull, çdo përjashtim duhet provuar me dokumente dhe është një proces që kërkon kapacitete të shtuara nga SUADA, duke vështirësuar zbatimin praktik të një listë të gjatë përjashtimesh. Këto kapacitete të shtuara do të përkthehen në kosto të shtuara.

Duke u mbështetur në këto praktika, KKDA-ja vendosi të adoptojë një qasje të rishikuar, e cila nga njëra anë konsiston në uljen e normave në përqindje dhe nga ana tjetër në eliminimin e çdo përjashtimi nga të ardhurat bruto që vijnë nga përdorimi i veprës. Kjo qasje synon të forcojë

transparencën, thjeshtësinë dhe konsistencën në procesin e mbledhjes së tarifave, duke krijuar një sistem më të unifikuar dhe të parashikueshëm për të gjithë palët e interesit. Si rrjedhojë, përjashtimet në bllok nga koncepti i të ardhurave bruto do të përbënin shmangie nga zbatimi i LDA-së dhe detyrimi për të paguar shpërblim për çdo formë apo mënyrë përdorimi ose shfrytëzimi të veprave së të drejtës së autorit.

Për sa më sipër, KKDA-ja ka marrë në konsideratë në mënyrë të kujdesshme secilin prej kritereve të parashikuara nga neni 142 dhe 149 të LDA-së, dhe ka zbatuar parimet dhe dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative në lidhje me vendimarrjen e saj. Gjithashtu, KKDA-ja ka vlerësuar, ndër të tjera, edhe faktorët e mëposhtëm:

- Vështirësitë në zbatimin praktik të metodologjisë së mëparshme, si dhe nevojën për miratimin e një metodologjie dhe tarifave të reja, të cilat të bazohen në kritere objektive, të qarta, të matshme, të llogaritshme dhe të zbatueshme në praktikë;
- Vendosjen e një ekuilibri të drejtë dhe të ndershëm midis palëve të përfshira në proces, duke marrë në konsideratë detyrimet ligjore dhe mungesën e konsensusit për marrëveshje gjithëpërfshirëse;
- Zbatimin e parimit të proporcionalitetit në mënyrë që tarifat të jenë jo vetëm të drejta dhe objektive, por edhe proporcionale në raport me shumën e të ardhurave bruto dhe masën e përdorimit së të drejtave të autorit nga subjektet përdoruese;
- Natyrën dhe llojin e aktivitetit të subjekteve përdoruese, si dhe masën e përdorimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit;
- Tarifat e zbatueshme nga vendet e rajonit dhe vendet e tjera që kanë një zhvillim ekonomiko-social të ngjashëm dhe të dhëna makroekonomike të krahasueshme, ku rezulton se në shumicën e këtyre vendeve (përfshirë Greqi, Bullgari, Rumani dhe Kroaci), zbatohet qasja e përlllogaritjes së vlerës së shpërblimit bazuar në të ardhurat bruto pa përjashtime dhe me normë në % më të lartë. Raporti krahasues thekson gjithashtu se në këto shtete “nuk ka bazë për përjashtime nga të ardhurat bruto” dhe rekomandon të njëjtën qasje për Shqipërinë.
- Standardet ndërkombëtare dhe nevojën për harmonizimin të akteve normative të brendshme me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe detyrimet që burojnë nga kapitulli 7 [E drejta e pronësisë aktuale] në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE;
- Faktorët ekonomik e social brenda vendit;
- Strategjitë e politikave të brendshme për zhvillim të qendrueshëm, zhvillimin e krijimitarisë artistike, si dhe nxitjen e zhvillimit të biznesit por në të njëjtën kohë dhe luftën kundër informalitetit.

3. ARSYETIMI I VENDIMIT SIPAS KATEGORIVE TË SUBJEKTEVE PËRDORUESE

Metodologjia është strukturuar sipas kategorive të subjekteve përdoruese, duke marrë në konsideratë natyrën dhe karakteristikat specifike të secilit lloj përdorimi të veprave të mbrojtura, por edhe rolin e përdoruesve si kontribues në pagesën e shpërblimit.

Tabelë 2. Mbi kategorinë e subjekteve paguese së të drejtës së autorit për vitin financiar 2024

Nr.	KATEGORIA E SUBJEKTIT	TË ARDHURAT (ME TVSH)	PËRQINDJE E TOTALIT TË TË ARDHURAVE
1	OSHMA	31 003 760	72,88%
2	NJËSI TREGTARE	4 224 840	9,93%
3	HOTELE	5 265 572	12,38%
4	RESTORANTE/BAR KAFE	280 800	0,66%
6	EVENTE	200 652	0,47%
7	KOPJA PRIVATE	1 563 631	3,68%
TOTAL		42 539 255	100,00%

Mbështetur në të dhënat e Tabelës 2 për vitin financiar 2024, të siguruara nga SUADA, rezulton se Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) përbëjnë kategorinë kryesore të përdoruesve që paguajnë tarifat e shpërblimit, me 72,88 % të të ardhurave të SUADA-s. Në vijim renditen: strukturat akomoduese (hotelet) me 12,38 %, njësitë tregtare me 9,93 %, restorantet/bar-kafe me 0,66 %, si dhe veprimtaritë e tjera të biznesit ku veprat komunikohen në publik (p.sh., evente) me 0,47 % të të ardhurave. Në vijim:

KATEGORIA I

Kjo Kategori përfshin ofruesit e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive, të cilat prezumohen si kategoritë me nivelin më të lartë të përdorimit të veprave të mbrojtura. Sipas Dokumentit të Monitorit të Pronësisë së Medias, në Shqipëri operojnë 6 radio kombëtare, 3 prej të cilave janë publike dhe 3 janë private. Përveç kësaj, ka 3 stacione radio ndërkombëtare dhe 4 stacione radio komunitare. Gjithashtu, janë 52 radio rajonale, 11 prej të cilave janë publike. Vlen për tu cituar se 9% e shqiptarëve dëgjojnë radio çdo ditë.³ Po ashtu, sipas Dokumentit të Monitorit të Pronësisë së Medias, në Shqipëri operojnë katër transmetues kombëtarë televizivë, një publik dhe tre privatë/tregtare. Shërbimi publik mediatik përfshin 16 kanale televizive rajonale dhe tematike. Po ashtu, ka 37 stacione televizive lokale dhe 21 kanale kabllore/IPTV/OTT. Kalimi në transmetimin digjital dhe shpërndarja e shtatë frekuencave tokësore digjitale u përfundua në vitin 2020 nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Dy nga frekuencat iu dhanë transmetuesit publik RTSH, ndërsa pesë të tjera iu shpërndanë transmetuesve privatë/tregtarë. Sipas AMA-s, në Shqipëri ekzistonin gjithashtu 62 rrjete kabllore, një ofrues IPTV, 14 ofrues OTT dhe një ofrues VOD. Përveç kësaj, vepronin edhe dy rrjete transmetimi satelitor: Digitalb dhe Tring TV.⁴

³ <https://albania.mom-gmr.org/en/media/radio/>

⁴ <https://albania.mom-gmr.org/en/media/tv/>

A. TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË RADIOT PUBLIKE, PRIVATE DHE LOKALE

Tarifa e shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet në formën e një përqindjeje të aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore të realizuara nga përdoruesi sipas klasifikimeve përkatëse në tabelat e tarifës bazuar edhe në kohëzgjatjen e komunikimit në publik. Të ardhurat bruto vjetore mund të sigurohen si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të lidhura në përputhje me nenin 142 pika 4 shkronja “a” të LDA. Në rast se të ardhurat nuk pasqyrojnë natyrën e përdorimit të veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, tarifat llogariten në bazë të kostove që lindin për përdorimin e tyre ose në bazë të ndikimit që kanë në shfrytëzimin normal nga mbajtësit e të drejtave, sipas nenit 142, pika 4, shkronja “c” i LDA. Në rastet kur përdorimi nuk sjell të ardhura, tarifa përcaktohet si përqindje mbi shpenzimet e përdorimit, në përputhje me nenin 149 pika 2 e LDA-së. Përcaktimi i tarifës merr në konsideratë edhe raportin e përdorimit ndërmjet veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, të mbrojtura dhe atyre jo të mbrojtura, si dhe faktin nëse përdorimi i objektit të mbrojtur është i domosdoshëm për aktivitetin e përdoruesit – kur ky aktivitet varet nga përdorimi – apo nëse ai nuk është thelbësor, por thjesht i dobishëm ose çlodhës, në përputhje me nenin 149 të LDA-së. Me qëllim përmbushjen e objektivave të argumentuara në seksionin 2 më sipër, përqindja e tarifës mbi të ardhurat bruto apo mbi shpenzimet, nëse nuk ka të ardhura bruto, është ulur, si për Radiot kombëtare publike/private ashtu edhe për ato lokale.

Është ruajtur parimi i aplikimit të një tarife të diferencuar, bazuar në kohëzgjatjen e transmetimit të veprës së mbrojtur brenda një programacioni 24 - orësh. Për radiot kombëtare publike dhe private edhe ato lokale, tarifat janë strukturuar në tre fasha/kategori kohore të transmetimit ($\leq 35\%$; $> 35\%$ deri- 65% ; $> 65\%$), duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka përdorimi i veprës dhe objekti i të të drejtave të lidhura në veprimtarinë e përdoruesit, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “ç” e LDA-së. Tarifat e diferencuara dhe të shprehura në përqindje pasqyrojnë rëndësinë dhe kontributin që jep vepra e mbrojtur në krijim e të ardhurave. Ky sistem synon të realizojë një shpërndarje të drejtë të barrës financiare mes përdoruesve, duke ngarkuar më shumë ato subjekte që përdorin dhe përfitojnë më shumë nga përdorimi i veprave të mbrojtura. Si rrjedhojë për ato kategori përdoruesish për të cilët përdorimi i objektit të mbrojtjes është i domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre, dhe kur aktiviteti i tij varet nga ky përdorim, zbatohet tarifë më e lartë.

Po ashtu është ruajtur lehtësia e parashikuar në Metodologjinë e mëparshme për Radiot lokale me xhiro të vogël, duke reflektuar vetëm ndryshimet që ka pësuar legjislacioni i posacëm. Konkretisht në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, i cili parashikon se *Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).*⁵ Për të mos ngarkuar me barrë administrative këto subjekte, dhe për të garantuar një shpërblim të drejtë për mbajtësit e të drejtave, parashikohet aplikimi i një tarife fikse, e përcaktuar sipas klasifikimeve në metodologji. Kjo tarifë fikse llogaritet duke marrë parasysh kohëzgjatjen e komunikimit në publik, por edhe numrin e publikut, të përcaktuar në licencën e lëshuar për aktivitetin e përdoruesit, të cilit i vihen në

⁵ Neni 11 ndryshuar me efekt nga 1 Janari 2021 me Ligj Nr. 122/2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 12.11.2020

dispozicion veprat ose objektet e të drejtave të lidhura në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “b” të LDA-së. Kjo qasje synon të sigurojë proporcionalitet dhe përballueshmëri, duke respektuar parimin e shpërblimit të drejtë për mbajtësit e të drejtave.

Nëse subjekti përdorues radiofonik i veprës së mbrojtur realizon të ardhura bruto vjetore ≤ 8 milionë lekë në vit, tarifa për t’u paguar është sa niveli i tarifës fikse. Ndërsa në rastet kur subjekti përdorues radiofonik i veprës së mbrojtur siguron të ardhura bruto vjetore > 8 milionë lekë, por nuk paraqet formularin e deklarimit të tyre, tarifa e detyrueshme për t’u paguar është sa dyfishi i tarifës fikse.

Në përllogaritjen e tarifave janë mbajtur në konsideratë edhe burimi i të ardhurave në formatin e subvencionit, abonimit dhe sponsorizimit, e përshkallëzuar, në masë më të ulët, në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga subvencionet për mbulimin e kostove operative, në masë më të rritur, në rastin e të ardhurave nga shërbimet e abonimit dhe në masa më të larta, në rastin e të ardhurave të marra nga reklamuesit dhe sponsorët tregtarë, në përputhje me nenin 142 pika 6 e LDA.

Për të nxitur korrektësinë në pagesë dhe për të garantuar qëndrueshmëri buxhetore, metodologjia parashikon një zbritje prej 10% në rastet e parapagimit të tarifës vjetore. Ky stimul financiar është në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe përfaqëson një mekanizëm efikas për sigurimin e të ardhurave për agjencitë kolektive dhe vetë përdoruesit. Në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh” të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave janë marrë në konsideratë tarifën e agjencive homologe në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme me Shqipërinë, si Greqia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Kroacia.

Në vendet e rajonit, tarifimi për transmetuesit radiofonikë - qofshin lokalë apo kombëtarë – bazohet në kriteret e qarta si shtrirja gjeografike, përqindja e kohës së transmetimit, burimet financiare të transmetuesit dhe të ardhurat bruto nga reklamat dhe sponsorizimet. Në Maqedoninë e Veriut, referuar tarifave të AAK-së ZAMP, mënyra e përcaktimit të tarifave për transmetimin radiofonik të veprave të mbrojtura ndryshon në varësi të faktit nëse radioja përdor apo jo një sistem elektronik për regjistrimin e përdorimit të muzikës. Kur ekziston një sistem i tillë elektronik, pagesa bëhet në formë tarife fikse, e cila llogaritet sipas kohëzgjatjes reale të transmetimit të veprave muzikore të regjistruara nga sistemi. Në mungesë të një sistemi elektronik të regjistrimit, tarifa e përdorimit do të përcaktohet si një përqindje e të ardhurave, të cilat përfshijnë fondet e tarifave të transmetimit dhe/ose abonimet, reklamat, sponsorizimet, grantet dhe të ardhurat nga programet. Konkretisht, për radiot lokale, përqindja varjon nga 2% deri në 3,25% të të ardhurave bruto vjetore, ndërsa për radiot kombëtare, kjo përqindje është nga 1,50% deri në 3,25% të të ardhurave bruto vjetore.

Në Rumani, referuar tarifave të AAK-së UCMR - ADA, radiot paguajnë një shpërblim tremujor për të drejtat e autorit, i cili u shpërndahet të gjithë mbajtësve të këtyre të drejtave. Shuma e pagesës llogaritet duke marrë si bazë të ardhurat që transmetuesi fiton nga transmetimi i muzikës gjatë tremujorit dhe duke aplikuar mbi to një përqindje fikse prej 4%. Kjo shumë më pas rregullohet sipas pjesës që zë muzika në kohën totale të transmetimit të programit.

Nëse transmetuesi nuk gjeneron të ardhura nga ky aktivitet, baza e llogaritjes nuk janë të ardhurat, por shpenzimet totale të bëra vetëm për transmetimin e muzikës gjatë tremujorit përkatës. Në këtë

mënyrë, tarifa përfundimtare reflekton si vlerën financiare të aktivitetit, ashtu edhe nivelin real të përdorimit të muzikës në programacion.

Në Greqi, referuar tarifave të AAK-së AUTODIA 2024, radiot paguajnë një tarifë prej 2.2% të të ardhurave bruto ose shpenzimeve, nëse nuk kanë të ardhura ose ato janë më të ulëta se shpenzimet. Por, pavarësisht nga llogaritja, radiot nuk mund të paguajnë më pak se vlerat minimale vjetore sipas madhësisë së audiencës së mbuluar - nga 400 € për radiot lokale (deri 500,000 banorë) e deri në 20,000 € për ato me mbulim kombëtar.

Kroacia, ndërkohë, vendos normën më të lartë - deri në 8% për transmetuesit kombëtarë - dhe zbaton tarifa minimale vjetore sipas licencës dhe mbulimit të popullsisë.

Këto praktika tregojnë se niveli i tarifimit është i lidhur drejtpërdrejt me shtrirjen dhe ndikimin e transmetuesit, duke justifikuar diferencimin ndërmjet radiove lokale dhe atyre kombëtare. Në këtë kuadër, metodologjia shqiptare për këtë kategori pasqyron një strukturë të qartë dhe të balancuar tarifimi, e ndërtuar mbi kriteret e ngjashme me ato të vendeve të rajonit, si përqindja e kohës së transmetimit muzikor në programacionin 24-orësh, niveli i shtrirjes së transmetuesit (lokal apo kombëtar), dhe të ardhurat bruto – ose shpenzimet operative, si dhe numri i popullsisë të përcaktuar në licencën e aktivitetit. Këto elemente e bëjnë këtë skemë të përshtatshme me realitetin ekonomik të sektorit audio dhe/ose audioviziv dhe në përputhje me parimet e mbrojtjes efektive të të drejtave të autorit.

B. TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË TELEVISION TË VEPRËS SË MBROJTUR NË TELEVISIONET PUBLIKE, PRIVATE DHE LOKAL

Tarifa e shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit edhe për këtë kategori përdoruesish përcaktohet në formën e një përqindjeje të aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore të realizuara nga përdoruesi sipas klasifikimeve përkatëse në tabelat e tarifës bazuar edhe në kohëzgjatjen e komunikimit në publik. Të ardhurat bruto vjetore mund të sigurohen si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të lidhura në përputhje me nenin 142 pika 4 shkronja “a” të LDA-së. Në rast se të ardhurat nuk pasqyrojnë natyrën e përdorimit të veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, tarifat llogariten në bazë të kostove që lindin për përdorimin e tyre ose në bazë të ndikimit që kanë në shfrytëzimin normal nga mbajtësit e të drejtave sipas nenit 142, pika 4, shkronja “c” i LDA-së. Në rastet kur përdorimi nuk sjell të ardhura, tarifa përcaktohet si përqindje mbi shpenzimet e përdorimit, në përputhje me nenin 149 pika 2 e LDA-së. Me qëllim përmbushjen e objektivave të argumentuara në seksionin 2 më sipër, përqindja e tarifës mbi të ardhurat bruto apo mbi shpenzimet, nëse nuk ka të ardhura bruto, është ulur gjithashtu, si për TV kombëtare publike/private ashtu edhe për ato lokale.

Po ashtu, është ruajtur parimi i aplikimit të sistemit tarifor të diferencuar referuar kohëzgjatjes së komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 - orësh, i strukturuar në katër kategori ($\leq 10\%$; $> 10\%$ deri 35% ; $> 35\%$ deri 65% dhe $> 65\%$), bazuar mbi indikatorët kohëzgjatje dhe niveli i përdorimit të veprës. Ky ndarje merr në konsideratë rëndësinë dhe funksionin që ka përdorimi i veprave dhe objekteve të të drejtave të lidhura për veprimtarinë përkatëse të përdoruesve, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “ç” të LDA-së si dhe raportin e përdorimit midis veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, të mbrojtura dhe jo të mbrojtura.

Tarifat e diferencuara dhe të shprehura në përqindje pasqyrojnë peshën, rëndësinë dhe kontributin e veprës në krijimin e të ardhurave për subjektin përdorues. Përcaktimi i tarifës merr në konsideratë edhe raportin e përdorimit ndërmjet veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, të mbrojtura dhe atyre jo të mbrojtura, si dhe faktin nëse përdorimi i objektit të mbrojtur është i domosdoshëm për aktivitetin e përdoruesit – kur ky aktivitet varet nga përdorimi – apo nëse ai nuk është thelbësor, por thjesht i dobishëm ose çlodhës, në përputhje me nenin 149 të LDA-së.

Me qëllim përmbushjen e detyrimit për pagesën e tarifës, është përfshirë gjithashtu penaliteti që në rast se subjekti përdorues nuk deklaron të ardhurat bruto vjetore, tarifa e pagueshme është sa tarifa vjetore më e lartë e paguar për AAK-të/Sportelin unik nga subjekte përdoruese të së njëjtës kategori (publik ose privat) në tre vitet e fundit.

Po ashtu është ruajtur lehtësia për TV lokale me xhiro të vogël, duke reflektuar vetëm ndryshimet që ka pësuar legjislacioni i posacëm, konkretisht neni 11 të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), i cili parashikon se *Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero)*⁶. Kjo situatë krijon lehtësi që këta TV përdorues të mos depozitojnë pasqyra financiare vjetore. Për të mos ngarkuar me barrë administrative këto subjekte, dhe për të garantuar një shpërblim të drejtë për mbajtësit e të drejtave, parashikohet aplikimi i një tarife fikse e përcaktuar sipas klasifikimeve në metodologji. Kjo tarifë fikse llogaritet duke marrë parasysh edhe numrin e publikut të mbuluar nga transmetimi përkatës, si një tregues objektiv i shkallës së shfrytëzimit të veprës në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “b” të LDA-së. Qasja synon të sigurojë proporcionalitet dhe përbalueshmëri, duke respektuar parimin e shpërblimit të drejtë për mbajtësit e të drejtave.

Në përlllogaritjen e tarifave janë mbajtur në konsideratë edhe burimi i të ardhurave në formatin e subvencionit, abonimit dhe sponsorizimit, e përshkallëzuar, në masë më të ulët, në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga subvencionet për mbulimin e kostove operative, në masë më të rritur, në rastin e të ardhurave nga shërbimet e abonimit dhe në masa më të larta, në rastin e të ardhurave të marra nga reklamuesit dhe sponsorët tregtarë, në përputhje me nenin 142 pika 6 e LDA.

Me qëllim nxitjen e korrektësisë në pagesë dhe për të garantuar qëndrueshmëri buxhetore, metodologjia parashikon një zbritje prej 10% në rastet e parapagimit të tarifës vjetore. Ky stimul financiar është në përputhje me praktikën ndërkombëtare të menaxhimit kolektiv dhe përfaqëson një mekanizëm efikas për sigurimin e të ardhurave për organizatat kolektive dhe vetë përdoruesit. Së fundi, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh” të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave janë marrë në konsideratë edhe tarifat e agjencive homologe në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme me Shqipërinë, si Greqia, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia.

Në vendet e rajonit të Ballkanit, tarifimi për transmetimin televiziv të veprave të mbrojtura bazohet në përqindje të të ardhurave bruto, të diferencuara sipas shtrirjes gjeografike të transmetuesit

⁶ Neni 11 ndryshuar me efekt nga 1 Janari 2021 me Ligj Nr. 122/2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 12.11.2020

(lokal, rajonal, kombëtar), përmbajtjes së programit dhe kohëzgjatjes së përdorimit të repertorit të mbrojtur.

Në Kroaci, tarifat për televizionet llogariten mbi bazën e 4% të të ardhurave të gjeneruara nga transmetimi i programeve televizive. Përveç kësaj, ekzistojnë tarifa minimale vjetore, të cilat ndryshojnë sipas nivelit të licencës dhe shtrirjes së mbulimit të stacionit: Televizionet me licencë qyteti paguajnë numrin minimal të pikëve të caktuara; Televizionet në qarqe dhe qytete kryesore kanë një nivel më të lartë pikësh; Televizionet rajonale, në kryeqytet dhe zonat përreth paguajnë edhe më shumë pikë; Televizionet kombëtare kanë numrin më të lartë të pikëve minimale.

Në Rumani, referuar tarifave të AAK-së UCMR –ADA, për transmetimin televiziv shpërblimi paguhet çdo tremujor dhe llogaritet si përqindje mbi bazën e llogaritjes, e cila përbëhet nga të gjitha të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i transmetimit (abonime, reklama, sponsorizime, fonde buxhetore, qira kohe programi, autorizime pritjeje, kontribute të tjera financiare etj.). Në mungesë të të ardhurave, përqindja aplikohet mbi totalin e shpenzimeve të bëra për transmetim. Në bazën e llogaritjes përfshihen edhe të ardhurat nga palë të treta, si kompani prodhimi ose reklame, kur lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e transmetimit. Përqindja e shpërblimit përcaktohet sipas përdorimit të muzikës: 3% e të ardhurave kur muzika zë 100% të kohës së transmetimit, ndërsa për përdorim më të ulët përqindja ulet proporcionalisht sipas formulës $x = 3y/100$, ku y është përqindja e kohës së transmetimit të zënë nga muzika.

Në Maqedoninë e Veriut, referuar tarifave të AAK-së ZAMP, për komunikimin në publik të veprave të mbrojtura në televizion parashikon që tarifat të përcaktohen ose si përqindje mbi të ardhurat bruto vjetore, ose si një shumë fikse nominale për çdo minutë transmetimi. Për shërbimet programore televizive në nivel lokal, tarifa varion nga 1,75% deri në 2,75% e të ardhurave bruto vjetore, në varësi të formatit të programit. Nëse aplikohet tarifa fikse, ajo është nga 27,08 deri në 40,16 denarë për minutë transmetimi. Për shërbimet programore televizive në nivel rajonal, tarifa përqindje varion nga 1,75% deri në 3,25% të të ardhurave bruto vjetore, ndërsa tarifa fikse për minutë është nga 59,45 deri në 93,41 denarë. Për shërbimet programore televizive në nivel shtetëror, tarifa përqindje është nga 1,50% deri në 3,25% të të ardhurave bruto vjetore, ndërsa tarifa fikse për minutë varion nga 317,12 deri në 545,20 denarë.

Në Greqi, sipas rregullave të AUTODIA-së për vitin 2024, çdo stacion televiziv që transmeton repertorin e mbrojtur paguan një shpërblim të llogaritur si 2,2% e të ardhurave bruto vjetore. Në rastet kur televizioni nuk ka të ardhura ose kur të ardhurat janë më të ulëta se shpenzimet, kjo përqindje aplikohet mbi shpenzimet totale të kryera për transmetimin. Megjithatë, për të garantuar një nivel minimal pagese, janë përcaktuar shuma fikse vjetore që varen nga mbulimi i popullsisë. Për stacionet që mbulojnë deri në 500 mijë banorë, tarifa minimale është 600 euro; për ato që mbulojnë nga 500 mijë deri në 2 milionë banorë është 1.200 euro; për mbulim nga 2 deri në 5 milionë banorë është 3.000 euro; ndërsa për stacionet me mbulim në të gjithë territorin grek, tarifa minimale arrin në 60.000 euro.

Në përputhje me praktikat e rajonit, metodologjia shqiptare për këtë kategori për transmetuesit televizivë mbështetet në parimin e proporcionalitetit, duke përdorur si bazë për llogaritje përqindjen e kohës së përdorimit të veprës në programacionin ditor dhe ndarjen ndërmjet

transmetuesve lokalë dhe kombëtare duke aplikuar norma progresive që rriten në varësi të intensitetit të përdorimit të repertorit të mbrojtur.

C. TELEVISIONE KABLLORE / IPTV / OTT / PLATFORMA DIGJITALE

Për përcaktimin e tarifave për përdoruesit e kategorisë TV Kabllore/IPTV/OTT/Platformat Digjitale është vijuar me një qasje të ndryshme nga ajo e TV-ve kombëtare dhe lokale, për shkak të karakteristikave të veçanta të këtyre shërbimeve dhe natyrës së veprimtarisë së tyre. Ndryshe nga metodologjia e mëparshme, janë ruajtur katër (4) fasha kohore të transmetimit, për të cilat tarifa progresive përcaktuar sipas nivelit të përdorimit përfshin katër nivele: $\leq 10\%$, $> 10\%$ deri 35% , $> 35\%$ deri 65% dhe $> 65\%$. Në këtë kuadër, vlerësohet se edhe fasha deri në 10% është e arsyeshme, duke marrë parasysh përfitimin real nga përdorimi i veprave të mbrojtura.

Tabela e tarifës fikse nuk është mbështetur tek numri i publikut të përcaktuar në licensën e aktivitetit të përdoruesit, të cilit i vihen në dispozicion veprat ose objektet e të drejtave të lidhura në respekt të nenit 142 pika 4 “b” të LDA-së por tek numri i abonimeve, kontratat e lidhur me klientët nga subjekti përdorues. Ky kriter reflekton natyrën e së drejtës së transmetimit dhe përputhet me nenin 142, pika 5, të LDA-së, mbahen në konsideratë për tarifën e zbatuara për ritransmetimin kabllor edhe numri i përdoruesve familjarë të lidhur në sistemet kabllore, si dhe natyra e programeve të ritransmetuara. Shuma e saktë e tarifave duhet të llogaritet duke marrë parasysh tarifën e abonimit por edhe kriteret e tjera të përfshira në nenin 142 dhe 149 të LDA.

Edhe në këtë kategori, aplikimi i një zbritjeje prej 10% për parapagimin e tarifës vjetore përfaqëson një stimul financiar, në përputhje me praktikën ndërkombëtare të menaxhimit kolektiv. Ky mekanizëm siguron parashikueshmëri dhe qëndrueshmëri buxhetore, si për agjencitë e administrimit kolektiv, ashtu edhe për përdoruesit.

Në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifën e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia.

Në vendet e rajonit si Kroacia, Greqia dhe Rumania, tarifimi për operatorët televizivë kabllorë, platformat IPTV, OTT dhe digjitale bazohet në lidhjen ndërmjet përdorimit të repertorit të mbrojtur dhe përfitimit ekonomik të përdoruesve, përmes përqindjes së të ardhurave apo shpenzimeve dhe tarifave fikse mbrojtëse.

Në Greqi, sipas tarifave të AUTODIA-së 2024 aplikohet një normë fikse prej $2,2\%$ mbi të ardhurat totale të shërbimit, në mënyrë proporcionale, me shpërblym minimal mujor prej $0,10\text{ €}$ për abonent.

Në Kroaci, tarifa aplikohet mbi të ardhurat ose mbi tarifën minimale vjetore. Për ritransmetimin me kablo, satelitor ose IP, tarifa minimale vjetore llogaritet duke marrë vlerën për pikë sipas licensës, të reduktuar me 30% , dhe më pas shumëzohet me numrin e abonentëve dhe programeve të ofruara. Për transmetimin në internet ose satelitor, tarifa minimale vjetore është 50% e tarifës minimale të nivelit më të ulët të licensës, ndërsa në rastet e transmetimit të njëkohshëm në disa modalitete, tarifa minimale vjetore rritet me 20% për çdo modalitet shtesë.

Në Rumani, sipas tarifave të AAK-së UCMR ADA, përqindjet variojnë nga 0.5% deri në 1.35% në varësi të kategorisë së mbajtësve të të drejtave dhe bazohen në të ardhurat mujore bruto apo shpenzimet, me detyrim raportimi mujor nga operatorët

Metodologjia shqiptare për këtë kategori, është ndërtuar mbi një logjikë tarifimi të kombinuar dhe të shkallëzuar, në përputhje me praktikën e konsoliduara të vendeve të rajonit. Njësoj si në Greqi dhe Rumani, ku përqindjet tarifore janë të lidhura ngushtë me të ardhurat apo shpenzimet dhe ku tarifën fikse aplikohet në mënyrë suplementare ose mbrojtëse, edhe metodologjia shqiptare parashikon që, për subjektet me të ardhura mbi një prag të caktuar (8 milion lekë), tarifa përqindore të plotësohet me një tarifë fikse minimale, e përcaktuar sipas numrit të abonentëve dhe nivelit të transmetimit të veprave të mbrojtura.

Për më tepër, ashtu si në Rumani, ku raportimi i të dhënave financiare është detyrim dhe bazë për përlllogaritje, metodologjia shqiptare ka parashikuar mekanizëm alternativ - aplikimin automatik të tarifës fikse - për subjektet që nuk raportojnë, duke garantuar kështu transparencë dhe shmangie të praktikave abuzuese.

Në funksion të garantimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, përgatitja e metodologjisë është shoqëruar me konsultime me grupet e interesit, duke u bazuar në parimin e përfaqësimit dhe të përfshirjes së aktorëve të tregut në procesin e përcaktimit të tarifave. Diskutimet e tyre përfshijnë:

Vodafone kundërshton propozimin për aplikimin e një tarife fikse prej 7 euro për abonent për platformat digjitale (IPTV, OTT). Sipas tyre, kjo tarifë është disproporcionale dhe çënon parimin e barazisë konsumatore, duke favorizuar teknologjitë tradicionale dhe ndikuar negativisht në zhvillimin e platformave digjitale vendase. Ata sugjerojnë që në vend të kësaj të aplikohet një përqindje më e ulët (2%) mbi të ardhurat nga abonimet, për të nxitur përdorimin dhe zhvillimin e teknologjisë digjitale. Kjo qasje është pranuar pjesërisht, pasi janë ulur tarifat e % për subjektet me të ardhura bruto vjetore mbi 8 milion lekë, por nga ana tjetër është ruajtur sistemi tarifor i diferencuar i cili pasqyron rëndësinë dhe kontributin e veprës në krijimin e të ardhurave për subjektin përdorues.

KATEGORIA II

Kjo kategori përfshin struktura akomoduese (hotele, motele, njësi akomoduese të tjera) si dhe ambiente ku shërbehet ushqim, pije etj. si dhe njësi shërbimi (qendra tregtare etj.), të cilët konsiderohen si përdorues të përgjithshëm. Për këta përdorues merren në konsideratë kriteret të përgjithshme objektive si: përdorimi i shumës totale duke mbajtur parasysh llojin e shërbimit, madhësinë e qarkut, mbulimin e popullsisë; licencimin dhe përdorimin parësor apo dytësor të veprës/objektit të mbrojtur, por edhe kriteret specifike.

A. TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË STRUKTURAT AKOMODUESE (SUBJEKTE PËRDORUESE - HOTEL/ MOTEL / NJËSI AKOMODUESE E TË TJERA TË NGJASHME) TË VEPRËS SË MBROJTUR.

Klasifikimi i strukturave akomoduese parashikohet në nenin 45 të ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar. Secila kategori e strukturave ⁷ klasifikohet me sistem të shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse:

- a) “Bujtinë” standard;
- b) “Fjetinë” standard, komfort;
- c) “Kamping” standard;
- ç) “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- d) “Motel” standard, komfort, superior;
- dh) “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje;
- e) “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- ë) “Fjetje dhe mëngjes” standard, komfort, superior;
- f) “Apartament” standard;
- g) “Bllok apartamentesh” standard;
- gj) “Vilë” komfort, superior;
- h) “Hotel i shpërndarë ” standard;
- i) “Strukturë akomoduese trashëgimisë kulturore” standard;
- j) “Dhomë” standard.

Në përcaktimin e tarifave për komunikimin në publik të veprës dhe objektit të mbrojtur nga të drejtat e lidhura janë mbajtur në konsideratë vecanërisht kërkesat e nenit 149, pika 5, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të” i ndryshuar, i cili parashikon se *“Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hotelieri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore”*. Për më tepër, sipas pikës 6 të po të njëjtës dispozite, në rastin kur vendoset të aplikohet një shumë totale, fikse, si përqindje ose si shumë minimale e shpërblimit, duhet të merren në konsideratë një sërë rrethanash që lidhen me përdorimin e objektit të mbrojtjes. Këto përfshijnë, tipin e përdorimit, vendin dhe vendndodhjen gjeografike, kategorinë dhe madhësinë e objekteve, kohëzgjatjen dhe numrin e përdorimit dhe diferencën e çmimeve në lidhje me biznesin e një përdoruesi. Po ashtu janë vlerësuar edhe kriteret e tjera të përfshira në nenin 142 dhe 149 të LDA-së.

Si tregues për përdorimin e veprave dhe objekteve të mbrojtura është përzgjedhur numri i dhomave të strukturës akomoduese. Ky tregues konsiderohet më i qëndrueshëm, transparent dhe lehtësisht i verifikueshëm në krahasim me treguesin e numrit të klientëve, i cili është më i ndryshueshëm dhe i vështirë për t’u monitoruar në mënyrë të qëndrueshme. Për llogaritjen e tarifës 1 (një) pikë = 10 (dhjetë) lekë. Tarifa është e diferencuar dhe në përcaktimin e masës së saj, përdoret edhe kriteri socio-ekonomik referuar vendndodhjes gjeografike, i bazuar në atraktivitetin turistik dhe zhvillimin ekonomik të qarkut në të cilin ndodhet struktura akomoduese. Qarku me atraktivitet të lartë turistik dhe zhvillim të lartë ekonomik - tarifa aplikohet në 100% të vlerës së përlllogaritur. Qarku me atraktivitet dhe zhvillim të mesëm - tarifa zbatohet në 80% të vlerës. Qarku me atraktivitet dhe zhvillim të ulët - tarifa zbatohet në 60% të vlerës. Ky indeks përfaqëson një mënyrë objektive dhe të matshme për të reflektuar kontributin ekonomik të strukturës akomoduese në

⁷ Ndryshuar me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024; nr. 99/2024, datë 12.9.2024. Fletore Zyrtare Nr. 164 datë 21/09/2015.

raport me përdorimin e veprave të mbrojtura. Për herë të parë, metodologjia përfshin edhe sistemin e yjeve si indikator për kategorizimin e strukturave akomoduese. Ky sistem është i mbështetur në kuadrin ligjor dhe institucional të përditësuar rishtazi, që siguron një vlerësim të standardizuar dhe të verifikuar për cilësinë dhe kapacitetin e ofrimit të shërbimit nga subjektet përkatëse.⁸

Në vijim, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifat e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Bullgari, Greqia, Maqedonia e Veriut, Serbia, Rumania dhe Kroacia.

Në Bullgari për përdoruesit e përgjithshëm, si restorante dhe objekte argëtimi, ambiente akomodimi, vende akomodimi ku muzika luhet "live", si dhe përmes regjistrimeve dhe sistemeve të zërit, transportit, vendeve tregtare ose rrjeteve për shitjen e mallrave ose ofrimi i shërbimeve të ngjashme, merret si bazë një shumë totale, duke marrë parasysh tiparet e përdoruesit. Zbritjet janë të specifikuara në detaje. Kriteret për vendosjen e tarifave janë si më poshtë: numri i vendeve, shtretërit, sipërfaqja e lokalit përkatës, kategorizimi i lokalit (yjet për akomodim), sezoni/jashtë sezonit, brenda/jashtë, orari i punës dhe të tjera⁹. Në Greqi, Metodologjia për subjektet përdoruese që kategorizohen si struktura akomoduese të Kategorisë c sipas tarifave të AAK-së AUTODIA 2024, zbatohen tarifa fikse. Kriteret marrin parasysh llojin e shërbimit, madhësinë e zonës, mbulimin e popullsisë dhe kushtet specifike si licencimi dhe përdorimi parësor i muzikës.

Për hotelet mbahet në konsideratë tarifa ditore për dhomë, bazuar në vlerësimin e yjeve të hotelit. Tarifa ditore është fikse dhe e ndryshme sipas yjeve të hotelit dhe përlogaritet për çdo dhomë.

Tarifat ditore për dhomat e hoteleve (për çdo dhomë në ditë përdorimi)

Kategoria e hotelit	Tarifa ditore për dhomë (€)
5 Yje	0,0115
4 Yje	0,0092
3 Yje	0,0069
2 Yje	0,00575
1 Yll	0,00500

Për hapësirat e përbashkëta të hoteleve, mbahet në konsideratë tarifa ditore dhe mujore bazuar në vlerësimin e yjeve të hotelit, duke përjashtuar baret, restorantet, sallat e eventeve dhe hapësirat për shfaqje të drejtpërdrejta. Hapësirat e përbashkëta/publike të hoteleve përfshijnë të gjitha hapësirat e hotelit, përveç bareve, restoranteve dhe sallave të eventeve, si dhe përveç hapësirave ku zhvillohen performanca artistike drejtpërdrejt (live) jashtë veprimtarisë së zakonshme të hotelit,

⁸ Ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin” ndryshuar me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024; nr. 99/2024, datë 12.9.2024. Fletore Zyrtare Nr. 164 datë 21/09/2015. Shih gjithashtu VKM Nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese” (Ndryshuar me VKM nr. 370, datë 29.05.2019; Nr. 415, datë 19.06.2019; nr. 240, datë 24.04.2025; nr. 316, datë 04.06.2025).

⁹https://www.musicautor.org/images/dokumenti/polzvateli/publichno_izpalnenie/Tarifa_HoReCa_2023_MUSICAUTOR.pdf

domethënë për argëtimin e klientëve ose të personave të tjerë, dhe në përgjithësi përveç të gjitha hapësirave që përdoren nga persona të tretë, fizikë dhe/ose juridikë, dhe që u drejtohen personave të ndryshëm nga klientët e hotelit (p.sh., kafeteritë, ambientet e argëtimit, restorantet). Për të gjitha këto raste, zbatohen tarifat përkatëse të performancës publike, sipas kategorisë ku realisht bëjnë pjesë, në përputhje me tarifat aktuale që zbatohen në prefekturat e Atikës dhe Selanikut. Tarifimi për secilën zonë të përbashkët bëhet në mënyrë të veçantë.

Tarifat për hapësirat publike/të përbashkëta të hoteleve

Kategoria e hotelit	Tarifa (€)
5 Yje	0,661
4 Yje	0,483
3 Yje	0,403
2 Yje	0,3186
1 Yll	0,288

Për dhoma me qira/apartamente dhoma/apartamente/akomodime turistike mbahet në konsideratë tarifa vjetore dhe sezonale bazuar në llojin dhe vendndodhjen e akomodimit (p.sh., Athinë, Selanik, ishuj, fshatra).

Në Rumani, strukturat e akomodimit tarifohen mbi bazën e klasifikimit të tyre zyrtar, i cili shprehet në yje për hotelet ose margarita për format e tjera të mikpritjes. Metodologjia e tarifimit mbështetet në përlogaritjen mujore të tarifës për çdo dhomë, me vlera që rriten në përpjesëtim me nivelin e klasifikimit. Kjo do të thotë se sa më e lartë të jetë kategoria e strukturës, aq më e lartë është tarifa përkatëse. Një strukturë me pesë yje, për shembull, do të ketë një tarifë më të lartë sesa një bujtinë me një margarita, duke reflektuar intensitetin më të madh të shfrytëzimit të veprave të mbrojtura në struktura me standard më të lartë dhe kapacitet më të gjerë mikpritës.

Në Kroaci, tarifimi për strukturat e akomodimit bazohet gjithashtu në klasifikimin zyrtar të strukturës, siç janë yjet apo çelësat për hotelet, resortet dhe vilat. Tarifat janë të diferencuara sipas kategorisë dhe aplikohen në dy forma: si tarifë sezonale (në periudhën e lartë turistike) ose si tarifë vjetore për strukturat që funksionojnë gjatë gjithë vitit. Përveç dhomave me qira dhe apartamenteve të tipit Airbnb, tarifimi përfshin edhe ambiente ndihmëse brenda strukturës si zonat e mëngjesit apo baret e pishinës, duke marrë parasysh përdorimin komercial të repertorit të mbrojtur në çdo pjesë të strukturës.

Në Maqedoninë e Veriut, Metodologjia për subjektet që kategorizohen si struktura akomoduese sipas tarifave të AAK-së ZAMP, përfshin: Hotele, Motele dhe Apartamente me qera, e të ngjashëm me to. Kriteret që mbahen në konsideratë: secili përcjellës në publik i veprës (nëpërmjet radio, tv, rrjet kabllor), është i vlerësueshëm në pikë. Subjektet kryejnë deklaratimet sipas kriterëve, në AAK-në përkatëse deri më datë 15 të çdo muaji paraardhës, në të kundërt aplikohet tarifë tjetër duke u bazuar sipas kapacitetit të ambientit. Në Republikën e Serbisë, Metodologjia për subjektet që kategorizohen si struktura akomoduese sipas tarifave të AAK-së SOKOJ: Hotelet dhe Të tjera të ngjashme me to. Shumat e tarifave të licencës për komunikim me publikun përcaktohen në bazë të: sipërfaqes së objektit të përdorur nga përdoruesi për pritjen e mysafirëve, konsumatorëve dhe

klientëve; rëndësisë së komunikimit në publik e veprave muzikore, shfaqjeve dhe regjistrimeve zanore për biznesin e përdoruesit dhe vendndodhjen gjeografike të ambientit të regjistruar të përdoruesit. Këto kritere janë të vlerësueshme me pikë.

Analiza e kriterëve dhe mekanizmave të tarifimit të zbatuar në metodologjinë shqiptare për strukturat akomoduese tregon përputhje me praktikën e vendeve të rajonit si Greqia, Kroacia dhe Rumania. Kjo qasje nuk reflekton vetëm karakteristikat e tregut vendas, por merr gjithashtu në konsideratë përvojat më të avancuara rajonale për të siguruar një sistem të drejtë, proporcional dhe funksional të shpërblimit për mbajtësit e të drejtave. Ndarja e strukturave sipas kapacitetit akomodues (numri i dhomave) është një praktikë e zakonshme në Kroaci dhe Rumani, ku tarifat diferencohen sipas madhësisë së subjektit, duke respektuar parimin e aftësisë paguese dhe duke shmangur mbingarkesën për strukturat e vogla. Shqipëria e ka përshtatur këtë model përmes sistemit mujor të pikëve, i cili është i lehtë për t'u zbatuar dhe transparent në përlllogaritje. Përfshirja e ndarjes gjeografike në kategori (I, II, III), sipas rëndësisë turistike të qarqeve, është një tjetër element i marrë nga praktikën e shteteve si Greqia dhe Kroacia. Kjo ndarje ndihmon në përcaktimin më të saktë të kapacitetit ekonomik të strukturave që operojnë në zona me nivel të ndryshëm zhvillimi turistik, duke mundësuar kështu një shpërndarje më të drejtë të barrës financiare. Një tjetër element me rëndësi është diferencimi sipas standardit të strukturës, përmes tarifave shtesë për dhomë të bazuara në numrin e yjeve. Ky komponent është gjithashtu i përbashkët me metodologjitë greke dhe rumune, ku hotelet me vlerësim më të lartë paguajnë tarifa më të larta për shkak të nivelit më të lartë të komercializimit dhe përfitimit nga përdorimi i repertorit të mbrojtur.

Në funksion të garantimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, përgatitja e metodologjisë është shoqëruar me konsultime me grupet e interesit, duke respektuar përfshirjen e aktorëve të tregut në procesin e përcaktimit të tarifave. Diskutimet e tyre përfshijnë:

Shoqata ATA HORECA, si përfaqësuese e interesave të bizneseve hoteliere, mbështet referimin në parimet dhe procedurat për përcaktimin e tarifave të shpërblimit në përputhje me nenin 142 të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, si dhe referencën në Metodologji sipas nenit 149 pika 5 të LDA. Ata vënë në pah se hotelet janë në nivel të dytë së bashku me njësitë tregtare dhe duhet të renditen pas bizneseve dhe kategorive që kanë përdorim dhe përfitim thelbësor nga përdorimi i muzikës si koncertet, shfaqet, performacat, diskot, pubet madje edhe ato pube dhe bare ku muzika është thelbësore. Ata kanë mbajtur qëndrimin se, niveli i tarifës me referencë në Metodologji si numër artopallantësh, numër pikësh që duhen mbledhur e jo vlerë direkte në lekë është e komplikuar dhe shumë më e lartë se në Europë. Duke propozuar, përdorimin e një marzhi referues zbritës prej 60-70% ndaj tarifave të aplikura në vendet e BE me ekonomi të krahasueshme për të njëjtat kategori subjektsh (bazuar në një mesatarare të 4-5 vendeve si: Greqia, Italia, Gjermania; Spanja e Franca). Po ashtu, propozojnë që baret e hotelit që shërbejnë vetëm për klientët e hotelit të përfshihen në kategorinë “ambiente të përbashkëta të hotelit”. Ndërsa Bare të dedikuara për shërbim ndaj klientëve të jashtëm, të trajtohen në kategorinë e përgjithshme të bareve, por jo në të njëjtën kategori me diskot dhe pubet për shkak të ndryshimit thelbësor në natyrën e aktivitetit dhe të përdorimit të muzikës”¹⁰

¹⁰ https://www.autodia.gr/media/files/47en-AUTODIA%20TARIFFS%202024_31.10.2024.pdf

Pretendimet e Shoqatës ATA HORECA janë pranuar pjesërisht. Janë respektuar rregullimet e nenit 142 dhe kriteret e nenit 149 sidomos pika 5 dhe 6 të LDA-së. Sistemi i pikëve është i thjeshtë, i auditueshëm dhe i krahasueshëm me modelet rajonale. Është përfshirë gjithashtu aplikimi i një zbritjeje prej 10% për parapagimin e tarifës vjetore, i cili përfaqëson një stimul financiar. Nga ana tjetër, natyra e përdorimit të veprës në bare dhe restorante është e ndryshme nga hapësirat ndihmëse të hoteleve. Muzika në bare është një element i rëndësishëm i aktivitetit tregtar dhe përdoret me intensitet më të lartë, ndërkohë që është e vështirë të verifikohet objektivisht nëse shërbimi kufizohet vetëm për klientët e hotelit. Përfshirja e bareve dhe restoranteve nga kategoria e hapësirave të përbashkëta është një zgjidhje e përshtatshme që synon shmangien e abuzimeve.

Në konkluzion, modeli shqiptar i Metodologjisë ka mënjeluar qasjen referuar numrit të përcjellësve në publik të veprës së mbrojtur duke u ndërtuar mbi bazën e standardeve rajonale, duke marrë në konsideratë dimensionet ekonomike, turistike dhe funksionale të sektorit të akomodimit. Ajo përfaqëson një mekanizëm të mirë balancuar që, në njërin anë i përgjigjet nevojës për të garantuar të drejtat e autorëve dhe mbajtësve të të drejtave, dhe në anën tjetër, i përshtatet realitetit të tregut shqiptar përmes një strukture të qartë të zbatueshme dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare në rajon.

B. TARIFA PËR KOMUNIKIM NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË VENDE KU KONSUMOHET USHQIME DHE/OSE PIJE

Për këtë kategori subjektsh përdorues, janë respektuar kriteret e përfshira në nenet 142 dhe 149 të LDA-së. Po ashtu është ruajtur përdorimi i të ardhurës bruto si një variabël indirekte. Kjo variabël nuk lidhet drejtpërdrejt me deklarin e të ardhurave reale nga subjekti, por modelohet në funksion të karakteristikave të aktivitetit, me qëllim përcaktimin më të drejtë dhe objektiv të tarifës. Përkatesisht, tarifa përlllogaritet duke u mbështetur në një sistem të diferencuar, i ndërtuar mbi disa tregues kryesorë:

Lloji i aktivitetit - subjektet klasifikohen në katër (4) kategori kryesore, sipas ndikimit që ka përdorimi i veprës së mbrojtur në vetë natyrën e aktivitetit dhe në krijimin e të ardhurave. Kjo ndarje synon të reflektojë rolin funksional të veprës në zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Në këtë drejtim kategoria e parë, që përfshin *pub-e, disko-clubs, karaoke, taverna, bar i hotelit, e të tjera* të ngjashme me to e kanë përdorimin e fonogramit të një rëndësie primare dhe si rrjedhojë në këtë kategori aplikohen pikët më të larta, ndryshe nga kategoritë e tjera të cilat komunikimi në publik i veprës së mbrojtur është dytësor për nga rëndësia e krijimit të të ardhurave dhe vetëm ndihmon aktivitetin e tyre. Si rrjedhojë në rend zbritës nga kategoria në kategori aplikohen pikë më të ulta për të pasqyruar rëndësinë e veprës në të ardhurat e subjektit përdorues.

Vendndodhja gjeografike e aktivitetit - janë parashikuar dy nëndarje të zonave gjeografike, të cilat pasqyrojnë potencialin tregtar të zonës ku ushtron veprimtarinë subjekti përdorues. Po ashtu, tarifa varet edhe nga oraret ku subjekti përdorues ushtron aktivitetin dhe kapaciteti i shërbimit.

Në kapacitetin e shërbimit - mbahet në konsideratë si tregues numri i publikut (i ndarë në gjashtë (6) grupe kapaciteti), i cili pasqyron madhësinë reale të veprimtarisë dhe nivelin potencial të shfrytëzimit të veprave të mbrojtura. Gjithashtu, përlllogaritja merr parasysh variabla të tjera ndihmëse, si, orari i zhvillimit të aktivitetit (në përputhje me legjislacionin në fuqi) të cilat ndikojnë në mënyrën dhe intensitetin e përdorimit të veprës së mbrojtur. Këto kritere vijnë në përputhje edhe me nenin 149, pikat 5 dhe 6, të LDA-së. Kjo qasje lejon përcaktimin e një shume totale për shpërblim, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të përdorimit të objektit të mbrojtur: tipologjinë e përdorimit, vendin dhe vendndodhjen gjeografike, kategorinë dhe madhësinë e objektit, kohëzgjatjen dhe numrin e përdorimit si dhe karakteristikat tregtare dhe diferenca e çmimeve në lidhje me biznesin e një përdoruesi. Në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifën e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Greqia e Rumania.

Në Greqi, metodologjia e AUTODIA-së klasifikon mjediset ku konsumohet ushqim dhe/ose pije në dy kategori kryesore: ato ku muzika është e domosdoshme për funksionimin e aktivitetit (si baret apo klubet ku shfaqjet live janë të zakonshme), dhe ato ku muzika ka funksion dytësor apo mbështetës (si restorantet apo fast-foode-t). Tarifa është fikse dhe përcaktohet mbi bazën e një sërë faktorësh si: lloji i subjektit, sipërfaqja në metra katrorë, vendndodhja (qytet, fshat, ishull i vogël apo i madh), si dhe kapaciteti i ambientit në rastet e ngjarjeve apo koncerteve. Tarifa aplikohet dhe paguhet në mënyrë mujore, bazuar në vetëdeklarimin e subjektit.

Në Rumani, metodologjia ndahet në dy nivele territoriale: për njësitë në qytete dhe vendpushime turistike, si dhe për ato në komuna dhe fshatra. Në të dyja rastet, kriteri kryesor për përcaktimin e tarifës është sipërfaqja e mjedisit (në m²), ndërkohë që parashikohen tarifa më të larta për sallat e ngjarjeve dhe mjediset ku zhvillohen performanca artistësh ose banda muzikore. Edhe në këtë rast, tarifën janë të strukturuar në bazë mujore dhe synojnë të reflektojnë intensitetin e përdorimit të repertorit të mbrojtur dhe përfitimin ekonomik që rezulton prej tij.

Në përputhje edhe me këto praktika, edhe skema shqiptare për tarifimin e komunikimit në publik të veprave të mbrojtura në vende ku konsumohen ushqime dhe/ose pije synon të krijojë një sistem të drejtë dhe proporcional, i cili merr në konsideratë një sërë faktorësh objektivë që reflektojnë intensitetin e përdorimit të repertorit të mbrojtur dhe përfitimin ekonomik të subjekteve. Ashtu si në Greqi ku tarifimi bazohet në sipërfaqe, vendndodhje dhe rëndësinë e muzikës për aktivitetin tregtar, apo në Rumani ku dallimet midis zonave urbane dhe rurale, si dhe prezenca e shfaqjeve live ndikojnë në çmim, në Shqipëri tarifa përcaktohet mbi një sistem pikësh të ndarë sipas kategorisë së aktivitetit, orarit të funksionimit, kapacitetit të pjesëmarrësve dhe frekuencës ditore në javë të eventeve. Ky sistem kumulativ mundëson ndarjen e barrës financiare në mënyrë të diferencuar dhe të drejtë, duke respektuar parimet e proporcionalitetit dhe barazisë, dhe duke garantuar një shpërblim të arsyeshëm për mbajtësit e të drejtave, në përputhje me parashikimet e nenit 142 e vijues të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, i ndryshuar.

C. TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË NJËSI TREGTARE DHE MJEDISE TË TJERA BIZNESI

Këtu përfshihen të gjitha mjediset e mbyllura dhe/të hapura të vendosura në një qendër tregtare si dyqane dhe njësitë tregtare të shërbimeve të tipit boutique; Mapo; Beauty point; Dyqan pajisjesh elektronike; Galeri të përhershme artistike (pikë shitjeje); Market/Supermarket; Sallon bukurie; Njësi shitjeje produktesh artizanale; Shërbime të tjera gastronomie që nuk kanë vende akomoduese për klientë (take away) apo të ngjashme me to, etj.

Janë respektuar gjithashtu kriteret e përfshira në nenet 142 dhe 149 të LDA-së. Në përputhje me nenin 149, pika 5, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të” i ndryshuar, “*Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hotelieri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore*”. Për më tepër, sipas pikës 6 të po të njëjtës dispozitë, në rastin kur vendoset të aplikohet një shumë totale, fikse, si përqindje ose si shumë minimale e shpërblimit, duhet të merren në konsideratë një sërë rrethanash që lidhen me përdorimin e objektit të mbrojtjes.

Si rrjedhojë për këtë kategori përdoruesish, metodologjia e tarifimit mbështetet në një sistem të diferencuar dhe të shkallëzuar, i cili synon respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe shpërndarjes së drejtë të barrës financiare. Treguesit kryesorë përfshijnë:

Së pari, sipërfaqja e ambientit - e ndarë në tre kategori ($\leq 100 \text{ m}^2$; $101 - 400 \text{ m}^2$; $>401 \text{ m}^2$) për të reflektuar dimensionin reale fizikë të subjektit përdorues. Tarifimi është zbritës, pra sa më e madhe është sipërfaqja aq më i ulët është pikëzimi (pra nga 1 pikë/ m^2 për ambientet me sipërfaqe më të vogël, deri në 0.5 pikë/ m^2 për ambientet me sipërfaqe më të madhe).

Në llogaritjen e tarifës 1 (një pikë) = 10 (dhjetë) lekë.

Së dyti, është përfshirë kriteri i vendndodhjes gjeografike, bazuar në nivelin e zhvillimit ekonomik të qarkut. Tarifa reduktohet sipas përfshirjes në Kategorinë II ose III nëse përdoruesit e veprave të mbrojtura, njësitë tregtare dhe mjediset e tjera biznesi janë të vendosura jashtë qendrave tregtare.

Nëse vepra e mbrojtur përcillet në mjediset e hapura/të mbyllura të përbashkëta publike (*hollet brenda/jashtë, tualetet dhe të tjera të përbashkëta në qendrat tregtare ku dyqanet administrohen nga subjekte të ndryshme*), koeficienti për llogaritjen e tarifës mujore është 1 (një) pikë/ m^2 . Kjo pasi, në këto hapësira fluksi i vizitorëve/klientëve është më i lartë se në një njësi tregtare të caktuar, dhe veprat e mbrojtura i komunikohen një publiku më të gjerë, përfshirë edhe vizitorë që nuk hyjnë në njësitë tregtare të caktuara. Ky faktor rrit ndikimin e komunikimit në publik mbi të ardhurat e subjektit dhe justifikon aplikimin e një tarife më të lartë në këto raste. Për më tepër, ky argument vjen edhe në respekt të parimit “kush përdor/fiton më shumë, paguan më shumë” duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë midis potencialit ekonomik dhe detyrimit financiar.

Për panaiet, ceremonitë festive, spektakleve dhe tregjeve të përkohshme të natyrave të ndryshme (me raste të caktuara), tarifa ditore është 300 (treqind) pikë. Arsyetimi bazohet në faktin se këto aktivitete janë afatshkurtra edhe tarifa për to konsiderohet e tillë dhe është disi më e lartë si

rrjedhojë e rëndësisë së komunikimit në publik të veprës së mbrojtur që është me e madhe dhe gjithashtu audiencës së konsiderueshme të cilës i komunikohet vepra. Ndërsa, për mjete lëvizëse, të cilat promocionin e realizojnë me altoparant, me qëllim krijimin e të ardhurave, vepra e mbrojtur në këtë rast do të tërhiqte vëmendjen e publikut duke ndihmuar gjithashtu në rritjen e të ardhurave. Si rrjedhojë duke e konsideruar si një ndikues indirekt në të ardhurat e subjektit përdorues, tarifa ditore është konsideruar të jetë më e ulët se ajo në festa dhe ceremoni të tjera por më e lartë se ajo në mjedise tregtare, konkretisht 10 (dhjetë) pikë.

Subjektet që paguajnë vlerën e plotë për 12 muaj brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës, përfitojnë zbritje nga vlera totale e tarifës në masën 10% të vlerës bruto për tu arkëtuar. Kjo shërben si masë nxitëse për pagesë të menjëhershme dhe sigurim e të ardhurave të qëndrueshme në favor të mbajtësve të të drejtave përmes administrimit kolektiv.

Në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifën e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Rumania dhe Kroacia.

Në Rumani dhe Kroaci, tarifimi për komunikimin në publik të veprave të mbrojtura në njësi tregtare apo shërbimi bazohet kryesisht në kriterin e sipërfaqes, me tarifa mujore që variojnë sipas madhësisë së njësive dhe pozicionimit gjeografik (me tarifa më të ulëta për njësitë në zona rurale ose komuna). Po ashtu, në Kroaci merret parasysh edhe lloji i njësive tregtare apo zyrës, duke reflektuar natyrën e aktivitetit ekonomik.

Kjo qasje është e përputhshme me metodologjinë shqiptare në këtë kategori, e cila ndërton tarifimin mbi sipërfaqen e njësive dhe aplikon koeficientë të ndryshëm në varësi të kategorisë së qarkut. Kjo strukturë shumëdimensionale siguron proporcionalitet dhe barazi, duke ndjekur të njëjtin logjikë me vendet e rajonit: sa më i lartë përfitimi i njësive aq më i lartë edhe kontributi për përdorimin e veprave të mbrojtura.

KATEGORIA III

AKTIVITETE BIZNESI TË TJERA KU KOMUNIKOHEN NË PUBLIK VEPRAT E MBROJTURA.

A.SHËRBIME TË TELEFONISË

Tarifa për shërbimet telefonike ringtone, nuk ka pësuar ndryshime duke qëndruar një tarifë varjabël e shprehur si përqindje mbi të ardhurat bruto nga shitjet e ringtoneve. Kjo ofron një model llogaritjeje të thjeshtë dhe funksional. Janë respektuar kriteret e përfshira në nenet 142 dhe 149 të LDA-së. Aplikimi i një tarife si përqindje në këtë rast është i justifikuar për disa arsye:

a) rëndësia thelbësore e veprës së mbrojtur në krijimin e të ardhurave - në këtë shërbim, vepra merr rëndësi primare dhe është vetë objekti i tregtimit, si rrjedhojë shpërblimi ndaj mbajtësve të të drejtave është plotësisht i justifikuar; b) evidenca e besueshme financiare - operatorët që ofrojnë

shërbime ringtone janë subjekte të licencuara, që publikojnë rregullisht pasqyrat financiare në QKB dhe raportojnë pranë autoriteve mbikqyrëse. Kjo mundëson verifikim të saktë të të ardhurave dhe numrit të abonimeve;

c) raporti kosto/përfitim - subjektet në këtë kategori nuk përballen me kosto shtesë për deklarimin e të dhënave mbi abonimet dhe të ardhurat, pasi këto janë të detyrueshme dhe të përfshira në dokumentacionin e tyre zyrtar. Duke u mbështetur në këtë logjikë ekonomike dhe ligjore, tarifa për komunikimin në publik të ringtone-ve është strukturuar si një tarifë e ndryshueshme, e shprehur në përqindje mbi të ardhurat bruto nga shitjet e ringtone-ve, në masën 4%. Ky model mbështetet në nenin 142 pika 4, shkronja “a” të LDA-së, që i referohet të ardhurave, si bazë për llogaritjen e tarifës, dhe nenin 149 pika 1 të LDA-së, që përcakton vendosjen e një përqindje mbi të ardhurat për përdorime thelbësore të objektit të mbrojtjes.

Tarifa për komunikimin në publik të ringtone-ve llogaritet mbi bazën e disa elementëve që, në bashkëpunim, sigurojnë një shpërblim të drejtë dhe proporcional për mbajtësit e të drejtave. Në qendër të formulës është numri i abonimeve për ringtone. Ky numër shumëzohet me vlerën e shitjes së ringtone, që është çmimi i vendosur për përdorimin e veprës. Ky çmim është tregues i drejtpërdrejtë i të ardhurave që realizohen nga përdorimi i veprës, dhe rrjedhimisht, sa më i lartë të jetë, aq më e madhe është përfitimi ekonomik i operatorit. Produkt i këtyre dy elementëve është të ardhurat bruto vjetore nga shitjet e ringtone-ve, një tregues kyç që pasqyron kapacitetin ekonomik të operatorit nga përdorimi i veprës. Kjo është baza financiare mbi të cilën aplikohet përqindja e tarifës, e cila në këtë rast është përcaktuar në masën 4%.

Nëse subjekti ofrues nuk deklaron të ardhurat nga shitja e shërbimit, tarifa do të jetë sa dyfishi i tarifës së llogaritur mbi të ardhurat e periudhës më të fundit të deklaruar. Ndërsa, në rast se subjekti ofrues është në treg për herë të parë dhe nuk siguron informacion për të ardhurat bruto nga shërbimi ringtone, atëherë tarifa do të jetë sa dyfishi i tarifës së llogaritur nga informacione të mbledhura nga të tretë në lidhje me të ardhurat e këtij subjekti. Po ashtu edhe për këtë kategori me qëllim nxitjen e korrektësisë në pagesë dhe për të garantuar qëndrueshmëri buxhetore, metodologjia parashikon një zbritje prej 10% në rastet e parapagimit të tarifës.

B. MJETET E TRANSPORTIT DHE TERMINALET E UDHËTARËVE

Në këtë kategori përfshihen të gjitha mjetet që ofrojnë shërbimin e transportit, përfshirë autobus, tren, anije, aeroplan, autobusët e agjensive të udhëtimit, taxi si dhe terminalët e pritjes së udhëtarëve, të cilët përbëjnë një pikë të rëndësishme të komunikimit në publik të veprave të mbrojtura.

Janë respektuar kriteret e përfshira në nenet 142 dhe 149 të LDA-së, vecantërisht neni 149, pika 5, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të” i ndryshuar, “Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hoteleri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore”. Si dhe pika 6 e po të njëjtës dispozite, në rastin kur vendoset të aplikohet një shumë totale, fikse, si përqindje ose si shumë minimale e shpërblimit, duhet të merren në konsideratë një

sërë rrethanash që lidhen me përdorimin e objektit të mbrojtjes. Nisur nga sa më sipër, për këtë kategori subjektsh përdoruese është ruajtur aplikimi i një tarife fikse.

Metodologjia parashikon që subjektet përdoruese të kësaj kategorie të tarifohen në bazë të pikëve mujore ose për udhëtim, në varësi të llojit të shërbimit që ofrojnë. Njësitë matëse janë të standardizuara dhe përfshijnë mjetin e transportit apo terminalin përkatës, ndërsa vlera e një pike është caktuar në masën 10 lekë.

Zgjedhja për aplikimin e një strukture tarifore fikse me bazë pikë përlllogaritjeje bazohet në disa konsiderata thelbësore:

Së pari, rëndësia dytësore që ka përdorimi i veprës në këto mjedise;

së dyti, vështirësia e sigurimit të evidencës mbi të ardhurat në një sektor ku raporti financiar është shpesh i fragmentuar ose në kushtet e mungesës së detyrimit për dorëzimin e pasqyrave financiare si rrjedhojë e regjimit të lehtësuar fiskal për subjektet me qarkullim deri në 8 milion lekë;

së treti, përdorimi i një tarife fikse për çdo njësi (mjet apo terminal), i lidhur me frekuencën e përdorimit (mujor, për udhëtim), lehtëson procesin e mbledhjes së tarifave nga SUADA dhe redukton kostot administrative për të dyja palët - autoritetin mbledhës dhe përdoruesin.

Me qëllim nxitjen e deklarimit dhe korrektësisë në pagesë dhe për të garantuar qëndrueshmëri në përmbushjen e detyrimit për të realizuar pagesën e tarifave për komunikimin në publik të veprave të mbrojtura, metodologjia parashikon edhe për mjetet e transportit/terminalit zbritje. Nga ana tjetër, në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, tarifa llogaritet 150% e tarifës më të fundit të paguar. Ndërsa, nëse subjekti ka filluar rishtas aktivitetin, në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, për të bërë llogaritjet përdoret informacioni i siguruar nga palë të treta për këtë subjekt përdorues.

Në vijim, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifën e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Kroacia e Rumania.

Në Rumani, organizata kolektive UCMR-ADA aplikon një sistem tarifimi të bazuar mbi njësi fikse mujore për mjetet e transportit tokësor dhe detar, pa u mbështetur në të ardhurat e realizuara nga operatorët. Kjo qasje bazohet në kritere objektive si lloji i mjetit dhe kapaciteti i tij, ndërsa për terminalët si aeroportet apo stacionet e trenit, tarifa fiksohet sipas vendndodhjes dhe natyrës së shërbimeve, duke shmangur kompleksitetin e përlllogaritjes mbi bazë të të ardhurave ose fitimeve.

E njëjta logjikë është ndjekur edhe në Shqipëri, ku zbatimi i tarifave fikse mujore ose për udhëtim përbën një mekanizëm transparent dhe të zbatueshëm që i përgjigjet më mirë realitetit të sektorit të transportit, duke reflektuar praktikisht parimet e përcaktuara në nenin 149 të LDA-së.

C. AMBIENTE DHE INSTITUCIONE KULTURORE, MUZEALE, ARTISTIKE

Kjo kategori përfshin një gamë të gjerë subjektsh përdoruese që ofron aktivitete kulturore dhe artistike me natyrë edukative dhe argëtuese, si koncerte, opera, teatro, ngjarje të tjera kulturore, muze, galeri arti, ekspozita, kinema etj.

Përdorimi i veprës së mbrojtur ose i objektit të të drejtave të lidhura në këto ambiente ka rëndësi parësore për aktivitetin e tyre, pasi komunikimi në publik i këtyre veprave është burim kryesor të ardhurash. Për këtë arsye, tarifa është shprehur si përqindje mbi të ardhurat bruto nga shitja e biletave, duke reflektuar lidhjen direkte midis përdorimit të veprës dhe përfitimit ekonomik të subjektit përdorues.

Ky parim ka udhëhequr hartimin e kësaj metodologjie dhe ka shërbyer si bazë për risinë në përcaktimin e tarifës për komunikimin në publik të veprave të mbrojtura për këtë kategori subjektsh, duke përfshirë tarifimin për komunikimin në publik për performancat live (në metodologjinë e mëparshme nuk përfshihen tarifa për performanca të drejtpërdrejta në koncerte) dhe duke ndryshuar modelin e mëparshëm të tarifës fikse për muzetë, galeri, ekspozita e kinematë) në respekt të kriterëve të përfshira në nenet 142 dhe 149 të LDA-së.

Në këtë kuptim, struktura e tarifimit për ambientet dhe institucionet kulturore, muzeale dhe artistike është ndërtuar mbi një kategorizim funksional, në përputhje me nenin 142 pika 4, shkronja “a”, të LDA-së që i referohet të ardhurave si bazë për llogaritjen e tarifës dhe nenit 149 të LDA-së, i cili parashikon mënyrat se si duhet të përllogaritet masa e shpërblimit nga tarifat, duke pasur parasysh natyrën e përdorimit, vendndodhjen, madhësinë e aktivitetit dhe ndikimin ekonomik të veprës së mbrojtur në aktivitetin e përdoruesit.

Tarifa për këto subjekte është e strukturuar në tre fasha, me përqindje zbritëse, të llogaritura mbi të ardhurat bruto nga shitja e biletave (6% të ardhurave bruto nga shitja e biletave për koncerte, opera dhe ngjarje kulturore; 3% e të ardhurave bruto nga shitja e biletave në Muze, Galeri Arti, ekspozita dhe parqe argëtimi/lojërash e të tjera të ngjashme me to dhe 2% e të ardhurave bruto nga shitja e biletave për Kinema).

Këto norma gjejnë argument në paragrafin 1 të nenit 149 të LDA-së, i cili parashikon se nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes është i domosdoshëm për aktivitetin e një përdoruesi dhe kur aktiviteti i tij varet nga ky përdorim, si në rastet e transmetimeve, koncerteve, valleve ose përdorimeve të tjera të objektit kundrejt pagesës, shuma e shpërblimeve do të jetë fikse në parim, si përqindje e të ardhurave ose fitimit nga një përdorim i tillë. Në këtë rast përdorimi i veprës merr rëndësi parësore.

Gjatë procesit të konsultimit, AAK-ja Albautor paaraqiti pretendimin që, për ngjarjet kulturore që nuk funksionojnë me sistem biletash, të shtohet një referencë e posaçme ndaj “shpenzimeve të organizimit” si bazë për përllogaritje, me mundësi modulimi të përqindjes në raste të veçanta, p.sh. deri në 5%, duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit dhe kostot reale të tij. Ky sugjerim është shqyrtuar dhe është marrë pjesërisht në konsideratë, në sqarimet përkatëse, pasi parimi i llogaritjes mbi bazën e shpenzimeve tashmë është i përfshirë në formulimin ekzistues, në përputhje me nenin 142 pika 4, shkronja “a” dhe nenin 149 të LDA-së. Megjithatë, është vlerësuar se përcaktimi paraprak i një norme të ndryshme për raste të veçanta do të cenonte fleksibilitetin e strukturës

tarifore dhe do të kërkonte një vlerësim rast pas rasti nga organi kompetent, bazuar në dokumentacionin justifikues të paraqitur nga organizatori.

Në vijim, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifën e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Bullgaria, Rumania, Kroacia dhe Greqia

Në këto vende tarifimi bazohet në kriterin e të ardhurave bruto apo të shpenzimeve - duke u referuar gjithmonë njëres prej tyre, cilado që rezulton më e lartë - si dhe në elementë të tjerë objektivë si lloji i organizatorit (privat apo publik), kapaciteti i ambienteve dhe numri i spektatorëve. Në këto vende, normat për koncertet dhe eventet kulturore variojnë nga 3% deri në 8%, ndërsa në mungesë transparence për të dhënat financiare, zbatohen tarifa fikse apo bazuar në sipërfaqe (për panairë dhe ekspozita), një praktikë që gjendet edhe në sistemin tarifor shqiptar për rastet kur subjekti nuk deklaron të ardhurat.

Në lidhje me kriteret e zbatueshme konkretisht:

Në Rumani, për performancat live sipas AAK- së UCMR- ADA¹¹ mënyra dhe kriteret si bazohet tarifa përfshijnë: Të ardhurat pa TVSH të përfituara nga përdoruesit nga përdorimi i veprave muzikore në koncerte, shfaqje apo ngjarje artistike si:

- shitjet e biletave për shfaqjen, koncertin ose ngjarjen artistike;
- të ardhurat e përfituara nga reklamat e ofruara nga shfaqjet, koncertet ose ngjarjet artistike;
- të ardhurat e përfituara nga transmetimi i shfaqjes, koncertit ose ngjarjes artistike;
- të ardhurat nga sponsorizimet e marra për shfaqjen, koncertin ose ngjarjen artistike;
- ndarja buxhetore ose çdo financim tjetër për çmimin e biletave të shfaqjes;

Disa shembuj:

Koncerte dhe shfaqje me muzikën si tipar kryesor

1. Koncert, Opera - 8% tarifa;
2. Karaoke - 4% tarifa

Në Greqi, për performancat live sipas AAK- së AUTODIA 2024, kjo kategori përfshin të gjitha objektet, bizneset dhe mjediset që funksionojnë si vende të argëtojnë dhe përdorin muzikë live për argëtimin e klientëve të tyre. Edhe kjo kategori përfshin sallat muzikore, d.m.th ambientet që funksionojnë si vende argëtimi, duke u ofruar klientëve muzikë live për argëtimin e tyre.

¹¹ <https://ucmr-ada.ro/legislatie/>

Në Bullgari, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të MUSICAUTOR¹², për koncertet dhe ngjarjet e tjera të ngjashme detyrimi për pagesën e shpërblimeve i takon organizatorëve të këtyre aktiviteteve.

Kriteri bazë për përcaktimin e tarifës është “vlera ekonomike” e çdo koncerti apo eventit tjetër, e cila përfaqëson dimensionin financiar të ngjarjes (pa TVSH) dhe përcaktohet individualisht për secilin rast, në varësi të: mënyrës së aksesit në event; të ardhurave dhe/ose shpenzimeve direkte dhe indirekte të lidhura me të.

Organizatori është i detyruar të paraqesë: dokumente të vërtetuara mbi të ardhurat/buxhetin e eventit; listën e saktë të veprave të ekzekutuara (setlist) dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për përcaktimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve.

Në rastet e përcaktuara shprehimisht në tarifë, gjatë llogaritjes së vlerës ekonomike merren parasysh: çmimi/buxheti i biletave; kapaciteti i vendit të zhvillimit (sipërfaqja dhe numri i vizitorëve). Detajet e vlerës ekonomike të eventit i referohen rasteve kur hyrja është me pagesë, Nëse ka sponsorë apo çfarëdo lloj mbështetjeje financiare nga shteti, kjo do të kontribuojë në vlerën ekonomike të koncertit apo eventit tjetër. Në rastet kur hyrja është falas, tarifa parashikon një listë gjithëpërfshirëse të kostove dhe të ardhurave të tjera që do të merren në konsideratë për llogaritjen e vlerës ekonomike. Përtej kësaj, tarifa përmban udhëzime të detajuara mbi procedurat e vlerësimit, duke synuar transparencë dhe bazë të drejtë për shpërndarjen e shpërblimeve.

Në Kroaci, tarifat për koncertet dhe përdoruesit e përgjithshëm përcaktohen mbi bazën e të ardhurave ose të shpenzimeve totale, duke u marrë parasysh gjithmonë vlera më e lartë. Në disa raste, si për evente të caktuara, tarifimi mund të bazohet në numrin e vendeve të uljes ose në sipërfaqen e hapësirës ku zhvillohet aktiviteti.

Për koncertet e organizuara nga persona fizikë ose juridikë privatë, norma e shpërblimit është 7% e të ardhurave bruto ose e shpenzimeve totale, cilado që është më e madhe. Të ardhurat përfshijnë shitjen e biletave, sponsorizimet dhe reklamat, ndërsa shpenzimet përfshijnë qiranë e vendit, tarifat e artistëve dhe kostot e zërit e ndriçimit. Për koncertet e organizuara nga persona juridikë publikë, tarifa është 5% mbi repertorin e përfaqësuar. Nëse të dhënat financiare nuk paraqiten brenda tre muajve, aplikohet një tarifë minimale e paracaktuar. Ngjarjet e veçanta, si ato sezonale, mund të kenë tarifa fikse, dhe për hapësirat akomoduese mund të vendosen tarifa vjetore, verore ose dimërore, në varësi të vendndodhjes dhe kategorisë së aktivitetit.

D. AMBIENTE SPORTIVE DHE TË TJERA

Në këtë kategori përfshihen stadiumet, pallatet e sportit, ambientet sportive, pishinat për publikun, sallat e lojërave sportive, shkollat e kërcimit, qendrat e fitnesit me apo pa qëllim fitimi e ambiente të tjera të ngjashme me to. Këto ambiente karakterizohen nga përdorimi dytësor - si sfond (faktor çlodhës), i veprave të mbrojtura..

¹² <https://www.musicautor.org/en/p/musicautor/tarifi-i-dogovori/tarifi>

Në përputhje me nenin 149, pika 5, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të” i ndryshuar, “Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hotelieri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore”. Për më tepër, sipas pikës 6 të po të njëjtës dispozite, në rastin kur vendoset të aplikohet një shumë totale, fikse, si përqindje ose si shumë minimale e shpërblimit, duhet të merren në konsideratë një sërë rrethanash që lidhen me përdorimin e objektit të mbrojtjes. Struktura e tarifimit është ndërtuar mbi një sistem pikësh mujor, i cili pasqyron intensitetin e përdorimit të veprave të mbrojtura, rolin që ato luajnë në përvojën e pjesëmarrësve dhe ndikimin ekonomik që ky përdorim ka për subjektin organizator. Ky sistem bazohet në elementë objektivë të matshëm, në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “a” të LDA-së, duke e bërë pikën treguesin kryesor të lidhjes midis natyrës së aktivitetit dhe nivelit të shpërblimit. Kjo strukturë dhe pikët në muaj nuk kanë pësuar ndryshime në raport me Metodologjinë e mëparshme duke u konsideruar të pranueshme dhe lehtësisht të zbatueshme.

Me qëllim nxitjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin për të realizuar pagesën e përdorimit si dhe për të nxitur korrektësinë në pagesë dhe për të garantuar qëndrueshmëri buxhetore metodologjia parashikon edhe zbritje. Ndërsa nga ana tjetër në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, tarifa llogaritet 150% e tarifës më të fundit të paguar. Nëse subjekti ka filluar rishtas aktivitetin, në rast të mosdeklarimit të informacionit të nevojshëm për llogaritjen e tarifës, për llogaritjet përdoret informacioni i siguruar nga palë të treta për këtë subjekt përdorues.

Në përputhje me nenin 142, pika 4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë në konsideratë krahasueshmëria me tarifat e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Kroacia dhe Rumania.

Në këtë drejtim, është shqyrtuar edhe praktika rumune, ku për stadiumet dhe sallat sportive aplikohet një tarifë fikse për çdo ngjarje, në varësi të llojit të aktivitetit, për përdorimin e muzikës si sfond gjatë zhvillimit të tyre. Kjo qasje ilustron tendencën drejt thjeshtimit të metodologjive të tarifimit për përdorime të përsëritura dhe të parashikueshme, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me faturimin mbi të ardhura.

DH. PËRDORIMI/PUBLIKIMI I VEPRAVE TË MBROJTURA NË INTERNET

Në raportin e ekspertës ndërkombëtare për Metodologjinë e tarifave, theksohet se ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit që ofrojnë paketa të përbëra nga interneti, televizioni dhe telefoni hasin vështirësi në llogaritjen e shumës që duhet të paguajnë tek Sporteli unik. Për më tepër, përdorimi i veprave në internet ka një karakter shumëdimensional dhe kompleks, që e vështirëson administrimin individual të të drejtave; si rrjedhojë, administrimi kolektiv i tyre është domosdoshmëri.

Si rrjedhojë në Metodologji është përfshirë edhe përdorimi i veprave në internet. Megjithatë, vlen të theksohet se për këtë kategori përdorimi, KKDA vlerëson se legjislacioni shqiptar nuk adreson në mënyrë të plotë zhvillimet dinamike të përdorimit të veprave të mbrojtura në internet. Rrjedhimisht, me ndryshimet ligjore të parashikuara në kuadër të përafrimit të legjislacionit

shqiptar me acquis e BE, mund të lindë nevoja për rishikimin e metodologjisë, duke reflektuar format e reja të përdorimit si dhe duke zgjeruar subjektet përdoruese.

Tarifat përcaktohen si përqindje mbi të ardhurat bruto të përdoruesit ose, në mungesë të tyre, mbi shpenzimet e deklaruara, duke respektuar rregullat e nenit 142 pika 4 dhe parimet e nenit 149, pika 1 dhe 2 të LDA-së. Për caktimin e masës së tarifës merren në konsideratë edhe vlera ekonomike e përdorimit të të drejtave, si dhe natyra dhe shkalla e përdorimit të objektit të mbrojtur. Mund të peshohen gjithashtu veçori të shërbimit online (p.sh. karakteristikat e shërbimit, kohëzgjatja e disponueshmërisë së veprave, lloji i publikut etj.). Si rrjedhojë, përqindjet aplikohen në rend rritës sipas kategorisë/natyrës së përdorimit.

Klasifikimi i kategorive dhe normat përkatëse janë si më poshtë:

- Kategoria I - Faqe që përdorin vepra të mbrojtura (muzikë, tekste, fotografi, vizatime, harta) si sfond gjatë navigimit online: 1% e të ardhurave bruto ose e shpenzimeve të deklaruara.
- Kategoria II - Shërbime podcasting, libra audio, leksione ose projekte të ngjashme: 2% e të ardhurave bruto ose e shpenzimeve.
- Kategoria III - Transmetim online i veprave të mbrojtura (p.sh. këngë, videoklipe, ilustrime, foto, tekste, ilustrime, vizatime topografike, krijime shkencore, skica, harta etj): 3% e të ardhurave bruto ose e shpenzimeve.
- Kategoria IV - Shkarkimi i veprave të mbrojtura (Këngë muzikore, Videoklipe, fotografi, ilustrime, tekste, vizatime topografike, krijime shkencore, skica, harta etj: 4% e të ardhurave bruto ose e shpenzimeve.

Nëse subjekti përdorues nuk deklaron të ardhura vjetore ose shpenzime, zbatohet tarifë fikse prej 12.000 lekë/vit, e llogaritur proporcionalisht me praktikën e ngjashme në shtetet fqinje. Kjo tarifë minimale, vendoset duke qenë se shpërblimi për përdorimin e veprave në internet zbatohet për herë të parë në Shqipëri dhe si e tillë synon futjen në skemë por edhe ndërgjegjësimin e kësaj kategorie përdoruesish dhe publikun në tërësi për respektimin e të drejtave të mbajtësve të tyre.

Në përputhje me nenin 142/4, shkronja “dh”, të LDA-së, gjatë përcaktimit të tarifave është marrë parasysh krahasueshmëria me tarifën e organizatave homologe të administrimit kolektiv në vende me sisteme juridike dhe ekonomike të ngjashme, si Bullgari, Kroacia, Greqia. Në këto shtete, përdorimi i muzikës për qëllime online ose si sfond licencohet me përqindje mbi të ardhurat bruto që, zakonisht, variojnë nga 1,5% në 3,5%, sipas natyrës dhe intensitetit të përdorimit (p.sh. transmetimi audio online, IPTV, video-on-demand, faqe me muzikë sfond).

Konkretisht, në Bullgari, sipas tarifave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të AAK-së MUSICAUTOR, të gjitha tarifën i nënshtrohen rregullimit në lidhje me normën e inflacionit. Shërbimet e transmetimit në internet i detyrohen një shpërblimi vjetor bazuar në një përqindje të të ardhurave të tyre të krijuara nga tarifën e abonimit, reklamat dhe forma të tjera të ardhurash. Përqindja specifike përcaktohet në bazë të madhësisë dhe shtrirjes së shërbimit.

Përdorimi online i veprave muzikore joskenike të HDS (Kroaci), përfshijnë të drejtat e riprodhimit, komunikimi në publik dhe vënia në dispozicion për publikun, për përdorime në internet. Baza e llogaritjes, mbështetet tek të ardhurat e përdoruesit; në mungesë të të ardhurave ose kur kostot tejkalojnë të ardhurat, kostot e përdorimit bëhen bazë. Shumat shprehen në përqindje dhe pikë minimale; vlera e pikës indeksohet çdo 1 janar. Përveç gamës së gjerë të përdorimeve parësore online përfshin edhe përdorime dytësore.

Ndërsa tarifat në Greqi sipas AAK-së AUTODIA 2024 -, Përdorimi në internet i muzikës është mjaft i detajuar, kështu për shembull për faqet e internetit me muzikë në sfond në navigim: Tarifa është 1.5% mbi të ardhurat totale të faqes së internetit, e llogaritur pro rata, me minimum shpërblimi mujor prej 30 €; Podcasting/Libra audio: Tarifa është 3.5% mbi të ardhurat totale të faqes së internetit, e llogaritur pro rata, me minimum shpërblimi mujor prej 49 €. Për Libra audio (Audiobooks): Për Abonime, tarifa është 2.5% mbi të ardhurat totale të faqes së internetit, në përpjesëtim me repertorin e përfaqësuar, me shpërblim minimal prej 0.0015 € për çdo audiolibër të komunikuar që përmban repertorin e përfaqësuar dhe me shpërblim minimal total prej 50 € në muaj. Ndërsa për shkarkim (download) - tarifa është, 0.05 € për çdo audiolibër të shkarkuar (që përmban repertorin e përfaqësuar) dhe shpërblim minimal total prej 60 €. Për streaming Video on Demand - komunikim në publik i veprave audiovizive me përdorim muzike, tarifa është 3.5% mbi të ardhurat totale të faqes së internetit/shërbimit, e llogaritur pro rata, me shpërblim minimal mujor prej 49 €. Për transmetim të muzikës sipas kërkesës (Këngë muzikore/Videoklipe, Tone Ringback): 10% e të ardhurave totale me honorare minimale mujore. Shkarkimi i veprave muzikore (Këngë muzikore, videoklipe, zile): 12% e të ardhurave totale me shpërblime minimale për vepër muzikore dhe totale të të ardhurave minimale mujore e kështu me radhë.

Struktura e propozuar për Shqipërinë, me norma % sipas kategorisë, ndjek të njëjtin parim të aplikimit të përqindjeve mbi të ardhurat bruto ose shpenzimet, duke marrë si pikë reference natyrën dhe intensitetin e përdorimit të veprës. Kjo e bën metodologjinë shqiptare të krahasueshme me praktikën e rajonit, me norma të moderuara në disa kategori, për të nxitur deklarinë dhe formalizmin e përdoruesve online, duke ruajtur proporcionalitetin ndërmjet përfitimit ekonomik dhe shpërblimit të autorëve.

Shtojca A

MENDIM PARALEL

Armando Bode, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (në vijim “**KKDA**”), është pajtuar me shumicën për miratimin e Vendimit Nr. _____, datë 21 / 08 / 2025, **“Për miratimin e Metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”** (në vijim “**Vendimi**”).

Megjithatë, ka shprehur mendim paralel për disa aspekte të Vendimit, si më poshtë vijon:

“Përkufizimi i “të ardhurave bruto”

Në pjesën e I të Vendimit, janë miratuar një numër përkufizimesh, me qëllim lehtësimin e zbatimit të Metodologjisë. Kjo është një praktikë e konsoliduar nga vendimet e mëparshme të KKDA, dhe miratimi i këtyre përkufizimeve është i rëndësishëm me qëllim zbatimin e drejtë të Metodologjisë, duke pasur në vëmendje që Ligji për të Drejtën e Autorit (Ligj Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura me to”, i ndryshuar) nuk përmban përkufizime¹³.

Specifikisht, është përcaktuar se ““Të ardhura bruto” nënkupton shumën totale të të ardhurave nga aktiviteti i përdorimit të veprës / objektit të mbrojtur, sipas deklarimit në organet kompetente.”

Ky është një përkufizim i rëndësishëm, pasi e ardhura bruto përbën bazën e përlllogaritjes së tarifës së aplikueshme për disa kategori përdoruesish, ndër të tjera për Kategorinë I që përfshin përdoruesit “radio” dhe “televizione”. Nga ana tjetër, siç është arsyetuar edhe në relacionin shoqërues të Metodologjisë, kuptimi i të ardhurave bruto dhe përqindja e aplikueshme mbi këto të ardhura bruto për përlllogaritjen e tarifës së aplikueshme, përbën një nga elementët bazë të mosdakordësisë të subjekteve përdoruese dhe Agjencive të Administrimit Kolektiv (AAK).

Sa më sipër, jam i mendimit se përkufizimi i dhënë për të ardhurat bruto nuk është i qartë për faktin se nuk përcakton se cilat burime të të ardhurave të përdoruesve të Kategorisë I, përfshihen për qëllime të përlllogaritjes. Natyrshëm lind pyetja: Çfarë është aktiviteti i përdorimit të veprës/objektit të mbrojtur? Ku deklarohen të ardhurat e gjeneruara nga ky aktivitet?

Në mendimin tim, hartimi i përkufizimit të mësipërm, cenon parashikueshmërinë, rrit rrezikun e trajtimeve të pabarabarta, vështirëson zbatimin në praktikë, duke u transformuar në një burim të mëtejshëm konflikti midis AAK-ve dhe përdoruesve.

Sa më sipër, cenon gjithashtu interesat ekonomike të mbajtësve së të drejtave.

Nën këtë arsyetim, hartimi i këtij përkufizimi mund të cenojë parimin e sigurisë juridike, i cili në thelb kërkon që normat të jenë të qarta, të kuptueshme dhe parashikueshme për subjektet të cilave i aplikohet. Një rregullim i pasaktë, sjell pasoja që nuk shkojnë në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synohet¹⁴.

Ndryshe nga sa arsyetohet në relacionin shoqërues të Vendimit, përkufizimi i të ardhurave bruto, nuk i shërben qëllimit të uljes së informalitetit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit, duke mos përmirësuar procesin e llogaritjes dhe të mbledhjes së tarifave për përdorimin e veprave të mbrojtura.

Përkufizimi i të ardhurave bruto mund të ishte miratuar në një nga opsionet e mëposhtme:

¹³ Përkufizimet e miratuara me akt nënligjor, Urdhër i Ministrit të Kulturës, nr. 138, datë 30.03.2017 “Për miratimin e manualit të përkufizimeve në zbatim të ligjit 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me to”, nuk përmban përkufizime që lidhen me rregullimet e Metodologjisë.

¹⁴ Në argumentimin e parimit të sigurisë juridike në kuadër të Vendimit, i referohem parimeve të elaboruara nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese së Shqipërisë, për analogji në vendime në të cilat është analizuar cenimi i sigurisë juridike në norma juridike. Shih p.sh: *Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 20 datë 03.04.2024 (V-20/24).*

Opsioni i parë, do të konsistonte në të ardhurat që gjenerohen në tërësi nga aktiviteti i shfrytëzimit të subjektit përdorues¹⁵. Baza e referimit në këtë opsion do të ishin pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Natyrshëm, impakti ekonomik i një përlllogaritje të tillë do të ishte i konsiderueshëm, dhe rrjedhimisht do të duhet të shoqërohej me përqindje më të ulëta, të cilat për kategorinë I të Metodologjisë, nuk duhet të kalojnë 1.5%.

Opsioni i dytë, do të ishte që të ardhurat bruto të nënkuptojnë shumën totale të të ardhurave nga aktiviteti i përdorimit të veprës / objektit të mbrojtur (sipas versionit të miratuar të Metodologjisë), por duke përcaktuar se cilat janë aktivitetet që konsistojnë në përdorim të veprës me objekt të mbrojtur, edhe për Kategorinë I, ngjashëm si për përdorues të tjerë si në Kategorinë III (C) ku është përcaktuar 'shitja e biletave'. Shembuj tipik të të ardhurave të gjeneruara nga OSHMA-të për përdorimin e veprës me objekt të mbrojtur, mund të ishin të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i transmetimit, apo cilado e ardhur që do të konsiderohej e pranueshme për qëllime të Ligjit për të Drejtën e Autorit.

Jam i mendimit se cilido nga opsionet e mësipërme do të ofronte një metodologji përlllogaritje më të lehtë, të drejtë dhe transparente duke kontribuar në përmirësimin e sistemit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtës së autorit në Shqipëri.

¹⁵ Për qëllime të “aktivitetit të shfrytëzimit”, i referohem terminologjisë të përcaktuar nga standardet e kontabilitetit: Shtojca-2-Pasqyra-e-performances_Formati-I.pdf dhe jo “shfrytëzimit të veprës me objekt të mbrojtur”.